

LIGJ
Nr. 83/2024

**PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË USHTARAKE TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Miratohet Strategjia Ushtarake e Republikës së Shqipërisë sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ligji nr. 72/2015, “Për miratimin e Strategjisë Ushtarake të Republikës së Shqipërisë”, shfuqizohet.

Neni 3

Ngarkohet Këshilli i Ministrave për nxjerrjen e akteve të nevojshme sipas përcaktimeve në Strategjinë Ushtarake të Republikës së Shqipërisë.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 26.7.2024.

Shpallur me dekretin nr. 285, datë 2.8.2024, të presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

STRATEGJIA USHTARAKE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Mesazhi i ministrit të Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë

Strategjia Ushtarake (në vijim “SU”) e Republikës së Shqipërisë (RSH) është dokumenti themelor, i cili përcakton synimet, objektivat dhe drejtimin për funksionimin dhe zhvillimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë (FARSH). Ajo është e bazuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe në Strategjinë e Sigurisë Kombëtare (në vijim “SSK”) dhe e hartuar me ekspertizë gjithëpërfshirëse.

Ky dokument strategjik, mbështetur në hierarkinë e dokumenteve strategjike të Republikës së Shqipërisë përcakton prioritetet në zhvillimin e kapaciteteve dhe harmonizimin e rrugëve dhe veprimeve që garantojnë përmbushjen misionit dhe detyrave të Forcave të Armatosura (FA) për t’iu përgjigjur më mirë sfidave të sigurisë, me të cilat përballlet aktualisht vendi.

Siguria dhe mbrojtja e vendit mbështetet në zhvillimin dhe përdorimin e integruar të elementeve të fuqisë kombëtare, nëpërmjet një qasjeje gjithëpërfshirëse ndërinstucionale. Nisur nga ndryshimet e mëdha në mjedisin strategjik të sigurisë SU, mbështetur në vlerësimin e mjedisit dhe përcaktimin e rreziqeve nga SSK-ja, jep drejtimet e përshtatjes të sistemit të mbrojtjes dhe detajon përqasjet dhe kapacitetet që nevojiten për përmbushjen e SU-së.

SU-ja merr në konsideratë dhe përfshin si pjesë të saj mjedisin e sigurisë euroatlantike dhe sfidat dhe kërcënimet e sigurisë të parashikuara në Strategjinë Ushtarake të NATO-s, si dhe mbështet politikat,

objektivat dhe synimet e NATO-s për ruajtjen dhe mbrojtjen e integritetit territorial të vendit dhe Aleancës, kur ajo do të nevojitet.

Republika e Shqipërisë nuk paragjykon asnjë shtet si armik dhe nuk ka synim të cenojë tërësinë territoriale, sovranitetin apo pavarësinë e shteteve të tjera. Forca ushtarake do të përdoret si mjet i fundit, kur të jenë shteruar të gjitha mundësitë e tjera dhe vetëm nëpërmjet vendimmarrjes së autoriteteve kushtetuese të vendit.

Bazuar në mjedisin e sigurisë dhe objektivat e vendit tonë në fushën e mbrojtjes, SU-ja identifikon parimet e politikës së mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë, bazuar në sigurinë dhe mbrojtjen kolektive dhe në integrimin dhe bashkëpunimin me organizmat ndërkombëtarë. Koncepti i sigurisë dhe i mbrojtjes i Republikës së Shqipërisë është i lidhur në mënyrë integrale me mbrojtjen kolektive të Aleancës.

Për këtë Forcat e Armatosura do të zhvillojnë kapacitete të luftimit, të mbështetjes së luftimit dhe të mbështetjes me shërbime të luftimit që do të jenë moderne, shumëpërdorimëshe, të afta dhe të ndërveprueshme për të përmbushur misionin, por edhe ato që janë detyrime të vendit tonë në kuadër të NATO-s, sipas konceptit të një grupimi të vetëm forcash për operacione kombëtare dhe ndërkombëtare, luftarake dhe joluftarake, brenda dhe jashtë vendit, më vete apo të drejtuara nga NATO-ja, BE-ja, OKB-ja apo koalicionet e vullnetit.

Forca e ardhshme do të jetë një forcë moderne me pajisje e sisteme të ndërveprueshme me ato aleate. Prioritet në modernizim do të kenë projektet për zhvillimin e kapaciteteve të mbrojtjes kundërajrore me bazë në Tokë, sistemet e objekteve fluturues pa pilotë dhe sistemet për zbulimin dhe neutralizimin e objekteve fluturues pa pilotë, krahas modernizimit të armatimit, mjeteve të transportit, mjeteve ajrore (helikopterë), mjeteve detare me kapacitete luftarake, si dhe rritjes së fuqisë së zjarrit.

Të vetëdijshëm se zhvillimi i kapaciteteve të kërkuara do të jetë i mundur vetëm duke përdorur me efikasitet burimet, buxheti i mbrojtjes do të alokohet për të mbështetur rekrutimin, promovimin dhe mbajtjen e personelit cilësor, duke krijuar mundësi për mbajtjen e nivelit të kërkuar të gatishmërisë dhe vijimin e proceseve të modernizimit të kapaciteteve dhe infrastrukturës. Në këtë kontekst, alokimi i të paktën 2% të PBB-së të shpenzimeve për mbrojtjen, do të mundësojë vijimin e procesit të modernizimit të FA-së.

Forcat e Armatosura do të kenë karakter të fortë kombëtar e patriotik, duke qenë një institucion i respektuar në shërbim të kombit me dashuri dhe krenari të palëkundur për atdheun. Forca e ardhshme do të vijojë të konsolidohet si forcë profesioniste e aftë dhe shumëmisionëshe, me operacionalitet dhe gatishmëri të lartë për përmbushjen me sukses të misionit dhe detyrave, brenda dhe jashtë vendit, në të gjithë spektrin e detyrave luftarake dhe joluftarake. Krahas forcave aktive, komponenti i integruar rezervist me aftësitë dhe kompetencat e tyre do të jenë burim ekspertize dhe alternativë për gjenerimin e forcave.

Për të siguruar një forcë të motivuar, me dinjitet dhe moral të lartë, krahas përmirësimit të kushteve për jetesë dhe stërvitje, do të vijojë rishikimi i kuadrit ligjor për përmirësimin e trajtimit, sikurse do të ofrohet arsimim bashkëkohor, drejtim, menaxhim cilësor dhe përkujdesje për personelin.

Si pjesë integrale e NATO-s dhe në kuadrin e bashkëpunimit ushtarak do të synohet rritja e kapaciteteve dhe zhvillimi i një force të përbashkët, me strukturë funksionale dhe unike komandim-kontrolli dhe struktura fleksibël, me gatishmëri të lartë operationale, si dhe me aftësi dhe kapacitete të ndërveprueshme me Aleancën, për pjesëmarrje në operacione, në kuadër të mbrojtjes kolektive apo për menaxhimin e krizave.

Pjesëmarrja në operacionet e NATO-s do të vijojë duke rritur nivelin e angazhimit të FA-së dhe cilësinë e përfaqësimit me kontribute në misionet dhe operacionet e drejtuara nga NATO/BE/OKB. Prioritet do të jetë kontributi në misionin e NATO-s në Kosovë (KFOR), por njëkohësisht do të intensifikohet bashkëpunimin dypalësh me aleatët dhe partnerët e rëndësishëm, me të cilët ndajmë interesat për sigurinë e vendit, rajonit dhe NATO-s.

MINISTËR I MBROJTJES
Niko Peleshi

Lënda

KREU I. VEÇORITË E STRATEGJISË USHTARAKE

1.1 Veçoritë e Strategjisë Ushtarake (SU) të Republikës së Shqipërisë

KREU II. MJEDISI STRATEGJIK I SIGURISË

2.1 Në nivel global

2.2 Në nivel rajonal

2.3 Në nivel kombëtar

2.4 Mundësitë që ofron mjedisi i sigurisë

2.5 Kërcënimet, rreziqet dhe sfidat e mjedisit të sigurisë

2.5.1 Kërcënime dhe rreziqe konvencionale

2.5.2 Kërcënime, rreziqe dhe sfida jokonvencionale

KREU III. PARIMET E POLITIKËS SË MBROJTJES, KONCEPTI STRATEGJIK DHE OBJEKTIVAT E PËRDORIMIT TË FARSH-it

3.1 Parimet e politikës së mbrojtjes

3.2 Koncepti strategjik i mbrojtjes i Republikës së Shqipërisë

3.3 Objektivat e zhvillimit dhe përdorimit të FARSH-it

KREU IV. OBJEKTIVAT STRATEGJIKË USHTARAKË, MISIONI, DETYRAT, NIVELI I AMBICIES (NiA) DHE KAPACITETET E FA-së

4.1 Objektivat strategjikë ushtarakë të Republikës së Shqipërisë

4.2 Misioni i FARSH-it

4.3 Detyrat e FARSH-it

4.4 Niveli i ambitions (NiA) i FARSH-it

4.5 Kapacitetet e FARSH-it

4.6 Struktura dhe organizimi i FARSH-it

KREU V. MBËSHTETJA ME BURIME TË MBROJTJES E FARSH-it

5.1 Burimet njerëzore dhe konsolidimi i forcës profesioniste

5.2 Modernizimi

5.3 Burimet materiale dhe mbështetja me shërbime

5.4 Infrastruktura

5.5 Burimet financiare

5.6 Mbështetja në kuadrin e bashkëpunimit ushtarak

Përfundime

Shkurtime

KREU I

VEÇORITË E STRATEGJISË USHTARAKE

Strategjia Ushtarake (SU) është dokumenti themelor që jep vlerësimin mbi tendencat kryesore që do të formësojnë mbrojtjen dhe sigurinë kombëtare bazuar në mjedisin ndërkombëtar gjeopolitik të sigurisë, sipas përcaktimeve të SSK-së. Gjithashtu, përcakton objektivat, parimet dhe konceptet kryesore për funksionimin dhe zhvillimin e sistemit të mbrojtjes, si dhe drejtimin e përdorimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë (FARSH). Ajo bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe në Strategjinë e Sigurisë Kombëtare (SSK).

1.1 Veçoritë e Strategjisë Ushtarake (SU) të Republikës së Shqipërisë

Strategjia Ushtarake e Republikës së Shqipërisë (RSH) është e orientuar nga sfidat e mjedisit aktual të sigurisë dhe angazhimet strategjike të vendit tonë, e cila është në harmoni me Konceptin Strategjik të NATO-s.¹ Gjithashtu, në këtë strategji janë reflektuar SU e NATO-s² dhe janë mbajtur parasysh implikimet dhe detyrimet që rrjedhin nga Koncepti i NATO-s për Shkurajimin dhe Mbrojtjen e Zonës Euroatlantike (DDA)³ dhe Koncepti Themelor i Zhvillimit të Luftimit të NATO-s (NWCC)⁴.

Strategjia Ushtarake e Republikës së Shqipërisë është dokument përgjithësisht i hapur i cili merr në konsideratë kushtet e reja, të ndryshuara të mjedisit të sigurisë, të cilat përcaktojnë ndjeshëm karakterin dhe veçoritë e saj.

Strategji në mjedis të paqëndrueshëm të sigurisë: në mjedisin e përkeqësuar të sigurisë globale,

Republika e Shqipërisë, njerëzit dhe interesat tona përballen me një gamë të gjerë rreziqesh dhe kërcënimesh të mundësuar edhe nga teknologjia. Agresioni i paprovokuar i Rusisë ndaj Ukrainës dhe përdorimi i forcës ushtarake pa kufizim, ka risjellë konfrontimet dhe kërcënimet konvencionale në Evropë me implikime të reja politike, ekonomike, sociale dhe ushtarake dhe ndikimin të paparashikuar në sigurinë e brishtë të rajonit tonë.

Strategji e një vendi anëtar të NATO-s, e mbështetur në Strategjinë Ushtarake dhe Konceptin Strategjik të Aleancës: Strategjia Ushtarake është dokument strategjik i Republikës së Shqipërisë. Siguria dhe mbrojtja e Republikës së Shqipërisë janë pjesë e mbrojtjes kolektive të NATO-s, me përfitimet dhe detyrimet përkatëse, që rrjedhin prej saj.¹ Strategjia Ushtarake i hap rrugë dhe kërkon harmonizimin e planifikimit kombëtar me planifikimin e mbrojtjes dhe operacional të Aleancës.

Strategji e formuluar pas miratimit të Strategjisë së Sigurisë Kombëtare (SSK): miratimi i SSK-së, përtej reflektimit të realitetit të ri të sigurisë, kërkon rishikimin e Strategjisë Ushtarake, e cila do të pasohet me rishikimin e Planit Afatgjatë të Zhvillimit (PAZH) të FARSH-it, planit të vendosjes së FARSH-së dhe planeve të tjera mbështetëse dhe operationale, për të harmonizuar planifikimin e mbrojtjes dhe atë operacional me planifikimin e Aleancës. Këto dokumente do të orientojnë transformimin e FARSH-it dhe zhvillimin e kapaciteteve për përmbushjen e detyrimeve, garantimin e sigurisë dhe përballimin e kërcënimeve.

Strategji e një force profesioniste: Strategjia Ushtarake synon zhvillimin e një force e cila të jetë e aftë për të përmbushur me cilësi misionin dhe detyrat, brenda dhe jashtë vendit, më vete apo me aleatët. Krahës forcës aktive do të zhvillohet komponenti rezervist/vullnetar, i integruar dhe në harmoni me strukturën, kapacitetet dhe nevojat e FARSH-it. Rritja e interesit për profesionin e ushtarakut dhe vendosja e karrierës së tij mbi bazën e performancës individuale dhe kolektive do të jenë në qendër të konsolidimit të forcës profesioniste. Kjo përjasje, e shoqëruar me rishikimin e vazhdueshëm të bazës ligjore për karrierën, trajtimin dhe mbështetjen e ushtarakëve, do të përmirësojë rekrutimin, qëndrimin dhe motivim të pjesëtarëve të FARSH-it, do të rrisë dinjitetin e tyre dhe cilësinë e Forcave tona të Armatosura.

Strategji e bazuar në planifikimin e kapaciteteve, mbështetur në burimet kombëtare dhe vlerësimin e rreziqeve e kërcënimeve: Strategjia Ushtarake konsideron zhvillimin e kapaciteteve të nevojshme për përmbushjen e misionit kushtetues dhe detyrimeve ligjore, duke qenë e informuar mbi rreziqet e burimet dhe e bazuar në skenarët e angazhimit të mundshëm të FARSH-it, si dhe duke konsideruar detyrimet në kuadër të Aleancës. Kjo metodologji planifikimi do të synojë zhvillimin e balancuar të kapaciteteve sasiore dhe cilësore, duke konsideruar cilësinë e organizimit, personelit, drejtimit, motivimit, trajnimit, pajisjes dhe ndërveprimit të kapaciteteve me aleatët.

Strategji Ushtarake e mbështetur në një sistem mbrojtje në proces riaktivizimi, zhvillimi dhe konsolidimi të elementeve kritike të tillë si: sistemi kombëtar të lajmërimit, planit të mbrojtjes së vendit të integruar në planet e Aleancës, infrastrukturës së sistemit të komandim-drejtim, industrisë ushtarake, rezervave strategjike dhe zgjerimit të infrastrukturës së vendit pritës.

Strategji e hartuar me ekspertizë gjithëpërfshirëse: hartimi i Strategjisë Ushtarake është bazuar në ekspertizën më të mirë të ushtarakëve aktivë dhe në rezervë, duke përfshirë komandantë, oficerë shtabi, ushtarakë pjesëmarrës në operatione kombëtare e ndërkombëtare, stafe akademike të institucioneve arsimore dhe studimore të FARSH-it, institucionet dhe ministritë e linjës, si dhe konsulencën e aleatëve strategjikë

KREU II MJEDISI STRATEGJIK I SIGURISË

Kjo pjesë pasqyron analizën e faktorëve që ndikojnë në mjedisin e brendshëm dhe të jashtëm të sigurisë, mbështetur në SSK dhe në konceptin strategjik të Aleancës.

Analiza e mjedisit strategjik të sigurisë, e shtjelluar në nivel global, rajonal dhe kombëtar, shërben për të përcaktuar përgjigjen institucionale të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë (FARSH) ndaj kërcënimeve për sigurinë e kombëtare në harkun kohor 2024–2029.

Koncepti i ri Strategjik i NATO-s, i aprovuar në korrik të vitit 2022 përcakton se tashmë ndodhemi në një kohë kritike për sigurinë, paqen dhe stabilitetin ndërkombëtar dhe se agresioni i Federatës Ruse

kundër Ukrainës ka ndikuar në mënyrë domethënëse stabilitetin, paqen dhe sigurinë evropiane. Në kushtet aktuale nuk mund të përjashtohet mundësia e një sulmi kundër sovranitetit dhe integritetit territorial të ndonjë vendi aleat.

Kompasi Strategjik i Bashkimit Evropian (BE), i aprovuar në vitin 2022, nënvizon se zona e BE-së është e rrethuar nga paqëndrueshmëria dhe konfliktet dhe përballet me luftë në kufijtë e saj. Kontinenti evropian gjendet përballë një përzierjeje të rrezikshme të agresionit të armatosur, aneksimit të paligjshëm, shteteve të brishta, fuqive revizioniste dhe regjimeve autoritare, duke krijuar premisa për kërcënime të shumta ndaj sigurisë evropiane në formën e terrorizmit, ekstremizmit të dhunshëm, kriminit të organizuar, kërcënimeve hibride dhe instrumentalizimit të emigrimit të parregullt.

Siguria e vendit tonë, si vend anëtar i NATO-s dhe si vend kandidat i BE-së është e ndërvuar edhe nga siguria e territorit të Aleancës Euroatlantike. Republika e Shqipërisë ka intensifikuar përpjekjet e saj për të rritur aftësitë ndaj përballimit të kërcënimeve me burim të brendshëm dhe të jashtëm.

2.1 Në nivel global

Agresioni ushtarak i paprovokuar i Federatës Ruse (FR) ndaj Ukrainës ka sjellë një përplasje gjeopolitike mes vendeve demokratike dhe atyre autoritare, duke vënë seriozisht në diskutim arkitekturën e sigurisë që pas përfundimit të Luftës së Ftohtë. Konflikti FR-Ukrainë ka sjellë më afër mundësinë e një përplasjeje të armatosur konvencionale mes FR dhe NATO-s, si edhe rrezikun e përshkallëzimit të kësaj përplasjeje në një konflikt bërthamor. Në dimensionin ekonomik, veçanërisht në aspektin energjetik ka shkaktuar tkurje të ndjeshme të ekonomisë globale, rritje të lartë të çmimeve të lëndëve të para, si edhe ka cenuar rëndë sigurinë ushqimore. Përdorimi i energjisë dhe ushqimit si armë dhe mjet presioni nga ana e FR-së ka sjellë çrregullimin e tregjeve dhe çmimeve globale të hidrokarbureve dhe drithërave, duke konsoliduar një realitet të ri strategjik në Evropë. Sabotimi i gazsjellësve Nord Stream 1 dhe 2 në ujërat ndërkombëtare të Detit Baltik e ka bërë NATO-n dhe vendet e saj anëtare që t'i kushtojnë një vëmendje të shtuar ruajtjes së infrastrukturës kritike energjike dhe nënujore në territorin e vendeve aleate. Kalimi i gazsjellësit TAP në territorin e vendit tonë dhe në detin Adriatik merr një rëndësi të shtuar strategjike në kontekstin aktual. Fuqi autoritare, si: Kina, Irani dhe Koreja e Veriut kanë zgjedhur të rreshtohen në krah të FR-së, duke krijuar një polarizim në gjeopolitikën globale. Këta aktorë do të vijojnë të paraqesin sfida dhe kërcënime të kombinuara në sferën politike, ushtarake dhe ekonomike me impakt negativ në mjedisin e sigurisë globale.

Terrorizmi, në të gjitha format dhe manifestimet e tij, i përcaktuar në Konceptin Strategjik të NATO-s si kërcënim asimetric më i drejtpërdrejtë për sigurinë e vendeve të NATO-s, mbetet një kërcënim konstant krahas gamës së kërcënimeve asimetrike dhe hibride. Teknologjitë në zhvillim dhe çorientuese po sjellin në skenën e sigurisë ndërkombëtare kërcënime të reja, veçanërisht ato që lidhen me hapësirën kibernetike, manipulimin e të dhënave, keqpërdorimin e inteligjencës artificiale dhe përdorimin e saj për motive ushtarake dhe të sigurisë.

Këtyre kërcënimeve i shtohen edhe ndryshimi i kushteve klimatike, për shkak të ngrohjes globale, me implikime të reja social-ekonomike për menaxhimin e fatkeqësive natyrore dhe krizave humanitare me ndikime negative për sigurinë.

Situata globale e sigurisë ka sjellë dhe rritje të emigracionit të pakontrolluar, duke sfiduar kapacitetet e qeverive në mbarë botën për menaxhimin e flukseve të emigracionit, të cilat sa vijnë e bëhen më të paparashikueshme. Për më tepër këto flukse mund të shfrytëzohen nga grupet apo organizatat kriminale për trafikun njerëzor, por edhe nga organizatat terroriste me synim ndërmarrjen e aktiviteteve terroriste.

2.2 Në nivel rajonal

Koncepti Strategjik i NATO-s thekson se vendet e Ballkanit Perëndimor (BP) përballen me kërcënime dhe sfida, mes të cilave ndërhyrjet dëmprurëse dhe keqdashëse të palëve të treta. Po ashtu, Kompasi Strategjik i BE-së thekson se siguria dhe stabiliteti në Ballkanin Perëndimor nuk janë ende të garantuara dhe ekziston frika reale e destabilizimit nga përkeqësimi i situatës së sigurisë.

Vendet e Ballkanit Perëndimor kanë ambicie për harmonizimin e politikave të brendshme me vendet e BE-së, por, paralelisht disa nga këto vende përballen me sfida, të cilët përpiqen të minojnë orientimin euroatlantik të vendeve të rajonit. Aktorë të huaj keqdashës të kryesuar nga FR-ja, duke shfrytëzuar Serbinë dhe Proxyt e saj në rajon, nëpërmjet mjeteve diplomatike, lidhjeve kulturore-fetare dhe aktiviteteve të inteligjencës, synojnë të shfrytëzojnë çështjet ndërtentike për të nxitur konflikte me synime dhe avantazhe gjeopolitike. Këto përpjekje destabilizuese të shfaqura në formën e kërcënimeve hibride

ndikojnë negativisht në mjedisin e sigurisë në Ballkanin Perëndimor, për rrjedhojë në mënyrë të drejtpërdrejtë ndaj misionit të NATO-s/KFOR dhe prezencës së BE-së në rajon. Në këtë kontekst, Serbia vazhdon të luajë rolin e politikës dualiste mes interesave ekonomike evropiane dhe ndjekjen e politikave të sigurisë të FR-së në rajon.

Po ashtu, rajoni vijon të përballët me një sërë kërcënimesh të përbashkëta siç janë ekzistenca e krimit të organizuar me lidhje rajonale e më gjerë, influenca të jashtme dhe faktorë të brendshëm që mundësojnë radikalizmin dhe tendenca të ekstremizmit të dhunshëm, cenim të marrëdhënieve ndëretnike, nivel i lartë korrupsioni, krim ekonomik favorizuar edhe nga shkalla e informalitetit, situatë problematike ekonomike dhe sociale, tranzicion i zgjatur dhe kulturë demokratike e pakonsoliduar, problematika të bartura ndërshtetërore dhe retorikë nacionaliste e shtuar.

2.3 Në nivel kombëtar

Mjedisi i brendshëm i sigurisë i vendit tonë është i qëndrueshëm, pa rreziqe imediate që mund të çojnë në cenim të integritetit territorial të vendit apo cenim të rendit kushtetues.

Si vend me orientim të qartë gjeostrategjik perëndimor, vend anëtar i NATO-s dhe vend kandidat në BE, me kontribute pozitive në vendimarrjet ndërkombëtare për çështje të sigurisë ndërkombëtare, paqes dhe stabilitetit, Republika e Shqipërisë mbetet një vend me interes për aktorët keqdashës globalë. Aktiviteti i tyre pritet të intensifikohet në kuadër të rritjes së konfrontimit dhe qasjes agresive të shteteve kundërshtarë me synime gjeostrategjike në cenim të arkitekturës aktuale të sigurisë ndërkombëtare dhe asaj evropiane, por edhe të qëndrimit dhe rolit aktiv dhe të qartë të Shqipërisë në koordinim me këta organizma. Ky aktivitet synon të ndikojë negativisht te sistemi politik, të influencojë politikisht dhe ekonomikisht në vendimarrjet e rëndësishme strategjike, të nxisë destabilitet, të ndikojë perceptimin publik, të rrisë skepticizmin dhe pengojë përpjekjet e vendit në raport me proceset eurointegruese.

Informacioni i klasifikuar dhe sistemet e komunikimit të sigurt janë të ekspozuara ndaj rreziqeve dhe kërcënimeve të sigurisë nga aktorë të ndryshëm shtetërorë dhe joshetërorë. Veprimtaria e shërbimeve inteligjente të vendeve jomike synon aksesin tek informacioni i klasifikuar “sekret shtetëror”, i NATO-s, BE-së dhe i shteteve të tjera me të cilat Republika e Shqipërisë ka nënshkruar “marrëveshje sigurie”, me qëllim cenimin e sigurisë kombëtare dhe dëmtimin e marrëdhënieve me aleatët.

Aktivitetet influencuese keqdashëse do të vijojnë me të gjitha format edhe nëpërmjet aktorëve të tretë, për të formësuar mjedisin informativ sipas interesave të tyre, pa përjashtuar përpjekje për ndërhyrje e influencim në proceset demokratike, mjet i përdorur tashmë në vendet e BE-së e më gjerë, për të cilën parlamenti i Republikës së Shqipërisë ka miratuar edhe një Rezolutë kundër ndërhyrjeve në proceset demokratike.

Sulmet kibernetike në shkallë të gjerë ndaj infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit nga aktorë keqdashës kibernetikë të sponsorizuar nga aktorë shtetërorë, si ato të vitit 2022 me origjinë nga Irani, dëshmojnë se siguria kibernetike duhet të marrë përparësi, në kuadër edhe të zhvillimit të digjitalizimit të shërbimeve publike për qytetarët. Infrastrukturat ekzistuese kritike të informacionit dhe projektet në evoluim, përveç progresit pozitiv për garantimin cilësor të shërbimeve dhe reduktimin e hapësirave për korrupsion, mbeten terren i kërcënimit për sulme kibernetike nga aktorë shtetërorë e joshetërorë për llogari të tyre, të cilët kanë jo vetëm synimet, por edhe kapacitetet për t'i realizuar ato. Sulmet kibernetike mund të përdoren edhe për motive spiunazhi kibernetik¹, për operacione informative, për arritjen e aksesit të synuar të paautorizuar, pasi kjo mundëson arritjen në kohë më të shkurtër të objektivave dhe mundësi më të ulëta për ekspozim dhe identifikim.

Siguria publike mbetet e cenuar nga aktiviteti me natyrë kriminale, me përdorim të eksplozivëve, vrasjeve me pagesë të drejtuara ndaj personit, kryesisht për motive të konflikteve personale, të interesave financiare, konflikteve pronësore, të trafikëve të paligjshme dhe rivalitetit mes grupeve kriminale.

Siguria ekonomike, pavarësisht reformave konkrete për uljen e informalitetit, rritjes së forcës goditëse të agjencive ligjzbatuese në luftën kundër këtyre fenomeneve, krimet në ekonomi vijojnë të jenë prezente e me impakt për ekonominë e vendit dhe rritjen e qëndrueshme të saj, forcimin e institucioneve shtetërore dhe sundimin e ligjit. Krimet në ekonomi janë sofistikuar nga teknologjitë e reja financiare dhe përbëjnë shqetësim për shkak të ndikimit në ekonomi. Pastrimi i parave dhe i produktit kriminal është problematikë prezente e me tendenca të larta impakti për ekonominë e vendit dhe sundimin e ligjit.

¹ Një akt i ndërmarrë në mënyrë të fshehtë ose nën pretendime false, që përdor kapacitete kibernetike për të grumbulluar informacion me synimin e komunikimit dhe transmetimit të tyre një pale kundërshtarë.

Siguria ekonomike mund të cenohet edhe nga përpjekjet e aktorëve globalë për të depërtuar në ekonomi për objektiva gjeoekonomikë e me synime për ta përdorur ekonominë si mjet presioni politik. Eksperienca e viteve të fundit ka treguar se fatkeqësitë natyrore dhe pandemike ndikojnë negativisht në buxhetin e shtetit të dedikuar për rritjen ekonomike.

Korrupsioni mbetet faktor që ngadalëson dhe dëmton procesin e reformave, si dhe dekurajon investimet e brendshme e të huaja, të nevojshme për të krijuar mundësi punësimi për të gjithë.

Problemet social-ekonomike vazhdojnë të jenë faktori kryesor që nxit emigrimin e parregullt të shtetasve shqiptarë, numri i të cilëve ka njohur rritje. Lëvizja e lirë, gjithashtu, mundësitë që ofron tregu global, ka sjellë rritje të largimeve të shtetasve shqiptarë nga vendi, mes tyre një numër nga profesionet jetike dhe gjeneratat e arsimuara në vend.

Siguria ushqimore si element mjaft i rëndësishëm i sigurisë njerëzore, me ndikim në shëndetin e popullatës, merr një rëndësi të veçantë në kushtet e krizës ekonomike, kushteve klimaterike në ndryshim dhe pandemieve. Etja për përfitime të shpejta financiare, moszbatimi i standardeve ka ndikuar në raste të cenimit të saj.

2.4 Mundësitë që ofron mjedisi i sigurisë

Prania e NATO-s, BE-së, si dhe OKB-së dhe OSBE-së, krahas forumeve dhe nismave të bashkëpunimit rajonal janë faktor stabiliteti dhe platformë për bashkëpunim, konsultime dhe arritjen e marrëveshjeve për zgjidhjen e çështjeve të sigurisë të ngelura pezull e në interes të procesit të integritetit.

Pozicioni gjeostrategjik i ka dhënë Ballkanit shansin të kthehet në një lidhëse të projekteve ekonomike, energjetike, infrastrukturore dhe teknologjike, i cili duhet vlerësuar si në aspektin e përfitimeve, ashtu edhe të masave që duhen marrë për forcimin e sigurisë dhe mbrojtjes. Perspektiva e përbashkët e rajonit nxjerr në pah nevojën për forcimin e sigurisë, duke rritur frymën e bashkëpunimit dhe minimizuar rreziqet dhe kërcënimet. Në fushën ushtarake janë krijuar iniciativa dhe struktura të përbashkëta rajonale, ka pjesëmarrje në operacione të përbashkëta dhe ndihmë të ndërsjellë në raste të emergjencave civile. Synohet që ky bashkëpunim të intensifikohet në të ardhmen.

2.5 Kërcënimet, rreziqet dhe sfidat e mjedisit të sigurisë

Kërcënimet, rreziqet dhe sfidat ndaj Republikës së Shqipërisë, si vend anëtar i NATO-s, pritet të jenë të natyrës konvencionale dhe jokonvencionale.

2.5.1 Kërcënime dhe rreziqe konvencionale

Rreziku i një agresioni ushtarak ndaj territorit të Shqipërisë konsiderohet i ulët, por situata aktuale e sigurisë ndërkombëtare në kufijtë lindorë të Aleancës ka rritur mundësinë që një sulm ushtarak ndaj njërit prej vendeve aleatë të NATO-s, si dhe detyrimet që burojnë nga zbatimi i nenit 5, të Traktatit të Atlantikut të Veriut, ta përfshijnë Shqipërinë në një konflikt konvencional, i cili mund të përshkallëzohet nëpërmjet përdorimit të armëve të shkatërrimit në masë. Shqipëria nuk mbështet dhe as synon përdorimin e forcës ushtarake për motive agresioni ndaj një vendi tjetër.

Aktorë të ndryshëm shtetërorë apo ndërshtetërorë, që nuk ndajnë të njëjtat vlera me demokracitë perëndimore, po intensifikojnë modernizimin e forcave të armatosura me ndikim dhe pasojë për stabilitetin dhe sigurinë rajonale dhe globale. Në këtë kontekst, Republika e Shqipërisë mbështet dhe merr pjesë në zhvillimin e kapaciteteve kolektive të Aleancës për kontribut në mbrojtjen e përbashkët të Aleancës. Kjo është e domosdoshme, kur konsiderohen kërcënimet që rrjedhin nga zhvillimet e fundit në krahun lindor dhe juglindor të Aleancës, të cilat parashikohen të zgjasin në kohë.

Rritja e investimeve në industrinë e mbrojtjes, shtimi i kapaciteteve ushtarake dhe blerja e sistemeve të armatimit me karakter sulmues, nga shtete apo entitete në Ballkanin Perëndimor, që kanë përkrahjen dhe përdoren si Proxy nga fuqi autoritare, ka potencial të dëmtojë besimin reciprok dhe ecurinë e dialogut në nivel rajonal, e mbase të fillojë një “garë armatimi” ndër vendet e Ballkanit Perëndimor. Militarizimi i rajonit dhe ekzistenca në të i “konflikteve të ngrira” me karakter etnik dhe politik, në rrethana të caktuara gjeopolitike, mund të degjenerojë në përplasje ushtarake, mbase dhe ndërshtetërore.

2.5.2 Kërcënime, rreziqe dhe sfida jokonvencionale

Shqipëria është e ekspozuar ndaj kërcënimeve, rreziqeve dhe sfidave jokonvencionale, si mund të përmenden: sulmet kibernetike, terrorizmi, radikalizmi dhe ekstremizmi i dhunshëm, ndikimet e huaja keqdashëse, fatkeqësitë natyrore dhe degradimi i mjedisit, krimi i organizuar, siguria e infrastrukturave kritike, siguria energjetike, si dhe emigrimi, shpërthimet pandemike dhe epidemike, si dhe kërcënimet hibride.

Sulmet kibernetike aktualisht janë kërcënimet më evidente në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar që përbëjnë rrezik potencial për sigurinë ndaj sistemeve dhe rrjeteve kompjuterike të Ministrisë së Mbrojtjes (MM) dhe Forcat e Armatosura (FA). Hapësira kibernetike është një fushë e re operationale e cila do të përdoret gjithnjë e më shumë si fushë konfrontimi dhe imponimi politik dhe ekonomik, në të cilën përfshihen edhe Forcat e Armatosura. Për shkak të rritjes së kërcënimeve kibernetike, të gjeneruara nga aktorë shtetërorë dhe joshetërorë, Forcat e Armatosura do t'i kushtojnë vëmendje të veçantë marrjes së masave që nevojiten për mbrojtjen kibernetike dhe garantimin e sigurisë së informacionit dhe sistemeve elektronike të komunikimit, si dhe fuqizimit të bashkëpunimit dhe koordinimit me institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare.

Terrorizmi dhe radikalizmi drejt ekstremizmit të dhunshëm, financimi i këtyre aktiviteteve, për shkak të influencave të jashtme, dhe aktorëve dhe faktorëve të brendshëm e rajonal do vijnë të përbëjë rrezik për kohezionin dhe vlerat e shoqërisë shqiptare, si dhe për harmoninë e bashkëjetesës tradicionale mes besimeve fetare në vend. Edhe pse në vendin tonë nuk ka pasur akte terroriste, ato nuk janë të përjashtuara për shkak të nxitjes e koordinimit nga organizata terroriste, prezencës së Luftëtarëve të Huaj Terrorist (LHT) nga vendi dhe rajoni ende të rreshtuar pranë këtyre organizatave, por edhe mbështetësve të tyre, të cilët të indoktrinuar nga propaganda *online* mund të veprojnë si aktorë të vetmuar. Influencat e jashtme të linjave ekstremiste fetare vijnë të influencojnë proceset radikalizuese në vend me synim futjen e virusit të ekstremizmit në komunitetet e paqta fetare në vend, cenimin e harmonisë dhe bashkëjetesës mes besimeve fetare.

Aktivitetet me ndikim keqdashës, si lajmet e rreme, dizinformimi, teoritë konspirative, me qëllime influencuese kanë njohur rritje, me impakt në perceptimin publik ndaj efektivitetit të funksionimit të sistemit demokratik dhe sigurinë në tërësi. Realitetet ndërkombëtare dëshmojnë se kjo formë grumbullimi e shpërndarje informacioni/dezinformacioni po ndikon në ekonominë, kohezionin social, marrëdhëniet politike, proceset demokratike dhe siguri. Ndërveprueshmëria e shpejtë, audienca e gjerë, ka bërë që ky mjet të përdoret me tendencë rritje dhe po sfidon besueshmërinë në informacionin e vërtetë, atë shkencor dhe efektshmërinë e qeverisjeve, krijojnë panik e kaos me impakt në sigurinë kombëtare.

Fatkeqësitë natyrore dhe degradimi i mjedisit, do vijnë të përbëjnë një kërcënim në rritje në raport me pamundësinë e parashikueshmërisë, impaktit njerëzor dhe ekonomik. Tërmetet, përmbytjet, zjarret masive, rrëshqitjet masive, kanë dëshmuar tashmë për nga dimensionin kërcënimin në rritje dhe impaktin e ndjeshëm në sigurinë njerëzore dhe atë ekonomike dhe kanë sfiduar kapacitetet ekzistuese për menaxhimin e tyre. Dukuria globale e ndryshimit të klimës ndikon negativisht në ekuilibrat natyrorë të Shqipërisë. Si pasojë, vendi mund të përballë me temperatura të larta që kanë një ndikim domethënës në florën dhe faunën e ambientit tokësor dhe ujor, thatësira të zgjatura dhe përmbytje të mëdha me një rrezik të shtuar për digat dhe hidrovolet, me kosto të konsiderueshme për dimensionin njerëzor dhe ekonominë kombëtare. Gjithashtu, krimi mjedisor ndikon në degradimin e mëtejshëm të mjedisit, i cili sjell pasojë afatgjatë në territor, peizazhin urban, shëndetësi, bujqësi, blegtori, peshkim si edhe në ekonominë e vendit në përgjithësi.

Krimi i organizuar ende mbetet fenomen kompleks e dinamik, edhe pse është rritur ndjeshëm forca goditëse, janë forcuar kapacitetet kundërvënëse. Grupet/individët e përfshirë në krimin e organizuar, kryesisht në trafikun, prodhimin e lëndëve narkotike, pavarësisht goditjeve domethënëse të aktivitetit të tyre kriminal, pasurive dhe të ardhurave nga ky aktivitet, kanë treguar aftësi në adaptimin e mënyrave të veprimit në raport me kundërvënien. Të ardhurat e aktiviteteve kriminale të siguruara ndër vite nga shkalla e informalitetit, pandëshkueshmëria apo ndërshekueshmëria e ulët favorizuar nga korrupsioni në sistemin e drejtësisë, ka sjellë injektimin në ekonominë formale dhe informale të parave të gjeneruara nga aktiviteti kriminal, zhvendosjen e elementeve të spikatura të grupeve kriminale në vendet e Evropës por edhe të prodhimit e origjinës së lëndëve narkotike. Gjithashtu, përdorimi i teknologjive të informacionit nga rrjetet kriminale si dhe zhvendosja e aktiviteteve të tyre në hapësirën kibernetike e vështirëson mundësinë e gjurmimit të tyre për t'i vënë para drejtësisë, duke ndikuar për rrjedhojë në rritjen e pandëshkueshmërisë së tyre. Këto elemente të integruara tashmë në rrjete ndërkombëtare të krimit të organizuar vijnë të nxisin e koordinojnë aktivitetin kriminal të grupeve dhe anëtarëve të tyre brenda vendit.

Siguria e infrastrukturave kritike merr përparësi në kushtet e kërcënimeve kibernetike në rritje, por

edhe për shkak se problematikat që lidhen me amortizimin e pajisjeve janë dobësi të cilat mund të shfrytëzohen nga terrorizmi dhe krimi i organizuar, duke amplifikuar dhe kërcënimet e tjera që lidhen me sigurinë e vendit.

Siguria energjetike, tashmë nuk është vetëm një kërcënim global por merr rëndësi parësore edhe në kërcënimet ndaj sigurisë kombëtare të RSH, që lidhet me disponueshmërinë e burimeve, pakësimin e burimeve hidrike për shkak edhe të kushteve klimaterike, amortizimin e kapaciteteve ekzistuese, rritjen e nevojave të popullsisë për konsum. Për më tepër, çrregullimi i tregjeve globale për shkak të nevojës për tregje alternative për të ulur dhe evituar varësinë nga shtetet kundërshtarë që përdorin edhe energjinë për motive presioni gjeopolitik do të ndikojnë në sigurinë energjetike. Në këto kushte, merr përparësi menaxhimi me efikasitet i infrastrukturës ekzistuese, rritja e masave mbrojtëse të sigurisë të kësaj infrastrukture nga sulme të mundshme kibernetike të cilat mund të jenë akte sabotazhi me kapacitet për ta çuar vendin në krizë.

Emigracioni i jashtëligjshëm transit në territorin e vendit tonë lidhet me rrugën ballkanike e cila vijon të mbetet një linjë e rëndësishme që shkon drejt Evropës dhe vendi ynë mbetet vend tranziti për kalimin e emigrantëve të paligjshëm. Vendi ynë nuk përjashtohet nga ndikimi i fluksit të emigracionit nga vendet e konfliktit, si një një transiti në linjën ballkanike.

Emigrimi i shtetasve shqiptarë me të cilin përballet vendi ynë ka njohur rritje. Lëvizja e lirë dhe mundësitë që ofron tregu global, si edhe faktorë të tjerë kanë sjellë rritjen e numrit të shtetasve shqiptarë të cilët largohen nga vendi, përfshirë ata nga profesionet jetike dhe shtresat e arsimuara. Problemet social ekonomike mbeten faktori kryesor që nxit emigrimin e parregullt të shtetasve shqiptarë, numri i të cilëve ka njohur rritje, ndërkohë që kërkesat e tregut të punës vendas kanë nxitur dukurinë e re të plotësimit të nevojave me fuqi punëtore nga vende të treta.

Shpërthimet pandemike dhe epidemike me natyrë mikrobiologjike, nga uji i pijshëm apo dhe nga lëndë të ndryshme kimike përbëjnë rrezik të lartë për sigurinë kombëtare. Pandemia SARS COV 2 gjatë 2020–2022 e vijim, H5N8 gjatë 2020–2021 në shpendë, janë ndër shpërthimet e fundit epidemike të cilat kanë prekur vendin tonë. Pandemia e shkaktuar nga COVID-19, dëshmoi dimensionin e impaktit në sigurinë shëndetësore, ekonomike. Sfidoi ndjeshëm infrastrukturën shëndetësore ekzistuese, dobësoi perceptimin publik në efektshmërinë e menaxhimit nga qeveritë, shkaktoi stres ekonomik, ankth te konsumatori dhe investitorët, rritje të papunësisë e për rrjedhojë të problematikave sociale. Ndikimi në ekonomi i shtoi një dimension të ri edhe konkurrencës midis regjimeve autoritare dhe atyre demokratike. Pandemia COVID-19 dëshmoi se si një situatë me vëmendje kaq të madhe publike e ndërkombëtare mund të përdoret nga aktorët kundërshtarë për motive gjeopolitike.

Sipas vlerësimit strategjik të riskut të vitit 2019, janë vlerësuar me risk shumë të lartë dhe të lartë 7 fatkeqësi të mundshme: antibiotiko rezistenca, bllokimet nga dëbora dhe ortehtë, tërmetet, gripi sezonal, përmytjet dhe ndotja e ajrit dhe sëmundjet me burim ushqimin dhe ujin; gjithashtu me risk të moderuar janë edhe zjarret masive, meningokoku invaziv, etet hemoragjike, CCHF, gripi pandemik, SARS, gripi i shpendëve, TB dhe fruthi. Mbrojtja e popullatës nga efektet shëndetësore të pandemive dhe sëmundjeve infektive emergjente, si dhe kërcënimeve kimike, biologjike, radiologjike dhe bërthamore duhet gjithashtu të konsiderohet prioritet.

Kërcënimet hibride përshkruhen si aktivitete keqdashëse shpesh të kombinuara me mjete ushtarake dhe joushtarake, në forma të fshehta dhe të hapura, duke përfshirë dezinformimin, sulmet kibernetike, presionin ekonomik, dislokimin e grupeve të armatosura të parregullta (*Proxy*) dhe përdorimin e forcave të rregullta. Vendi jonë është i ekspozuar ndaj kërcënimeve hibride të mbështetur nga aktorë të ndryshëm shtetëror ose joushtetëror, që kanë synime dashakeqëse ndaj vendit. Vitet e fundit metodat dhe intensiteti i kërcënimeve hibride janë rritur ndjeshëm. Përgatitja për të parandaluar, kundërshtuar dhe për t'iu përgjigjur sulmeve hibride mbetet një prioritet për Shqipërinë si vend anëtar i NATO-s. Aktivitetet hibride konsiderohen sfida për sigurinë ndaj institucionit të MM-së dhe FA-së, pasi ndikojnë si në sferën ushtarake, ashtu edhe në atë civile. MM/FA zhvillojnë kapacitetet e nevojshme për identifikimin në kohë dhe përballjen me kërcënimet hibride të organizuara dhe të drejtuara nga shtete, organizata, grupime apo individë jomiqësorë.

KREU III

PARIMET E POLITIKËS SË MBROJTJES, KONCEPTI STRATEGJIK DHE OBJEKTIVAT

E PËRDORIMIT TË FARSH-it

Ky krye trajton parimet themelore të politikës së mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë, Konceptin Strategjik të NATO-s, rolin e Forcave të Armatosura në mjedisin e pritshëm të sigurisë, si dhe konceptet themelore të zhvillimit dhe përdorimit të forcës së ardhshme.

3.1 Parimet e politikës së mbrojtjes

Strategjia Ushtarake bazohet në parimet e politikës së mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë, të cilat sanksionohen në SSK, duke pasqyruar kërcënimet dhe rreziqet për sigurinë kombëtare të vendit tonë, atë rajonale dhe globale. Ky dokument i rëndësishëm strategjik zëvendëson atë të vitit 2014, për t'iu përgjigjur më mirë sfidave të sigurisë dhe mbrojtjes me të cilat përballlet aktualisht vendi ynë, pas zhvillimeve gjeopolitike të dekadës dhe viteve të fundit. Parimet themelore të politikës së mbrojtjes, të mbështetura nga kjo strategji, janë:

Politikë mbrojtëse dhe paqësore: politika e mbrojtjes e Republikës së Shqipërisë nuk paragjykon asnjë shtet si armik dhe nuk ka asnjë synim të cenojë tërësinë territoriale, sovranitetin apo pavarësinë e shteteve të tjera. Në të gjitha rastet, më vete apo si anëtare e Aleancës, Shqipëria do të përdorë forcën ushtarake si mjet të fundit, kur të jenë shteruar të gjitha mundësitë e tjera dhe vetëm nëpërmjet vendimmarrjes së autoriteteve kushtetuese të vendit. Ajo, në asnjë rrethanë, nuk do ta përdorë forcën ushtarake si qëllim në vetvete për aneksimin e territoreve të vendeve të tjera.

Përdorim sinergjik i elementeve kryesore të fuqisë kombëtare: siguria dhe mbrojtja e vendit mbështetet në zhvillimin dhe përdorimin e integruar të elementeve të fuqisë kombëtare, nëpërmjet një qasjeje gjithëpërfshirëse ndërinstitucionale. Krahas komponentit politik (diplomatik), ekonomik, informues e social, Forcat e Armatosura luajnë rolin e tyre vendimtar në sistemin e sigurisë dhe mbrojtjes së vendit.

Politikë kombëtare mbrojtëse e ndërthurur me sigurinë dhe mbrojtjen kolektive: koncepti i sigurisë dhe mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë është i lidhur ngushtë me konceptin e sigurisë së Aleancës. Planifikimi i sigurisë dhe i mbrojtjes kombëtare bëhet në harmoni me SU-në e NATO-s, Konceptin e NATO-s për Shkruajim dhe Mbrojtje të Zonës Euroatlantike (DDA), dhe zbatohet nëpërmjet Planit Strategjik të Zonës së Përgjegjësisë së Komandës Strategjike të Aleancës për Operacionet dhe Familjes së Planeve. Shqipëria gjithashtu synon të jetë pjesë e Bashkimit Evropian dhe kjo strategji mban në konsideratë Politikën e Përbashkët të Sigurisë dhe të Mbrojtjes së BE-së.⁶

Politikë mbrojtëse e bazuar në bashkëpunim: Strategjia Ushtarake njeh dhe pranon faktin se me integrimin në organizmat ndërkombëtarë, Shqipëria është bërë pjesë e realitetit rajonal dhe global në fushën e sigurisë, ku asnjë vend nuk mund të garantojë siguri e paqe të qëndrueshme më vete. Në këtë kontekst, Strategjia Ushtarake mbështet pjesëmarrjen aktive në iniciativat rajonale, në interes të ndërtimit të një klime të bashkëpunimit dhe mirëbesimit rajonal.

3.2 Koncepti strategjik i mbrojtjes i Republikës së Shqipërisë

Koncepti i sigurisë dhe i mbrojtjes i Republikës së Shqipërisë është i lidhur në mënyrë integrale me Traktatin e Uashingtonit dhe Konceptin Strategjik të Aleancës. Si vend anëtar i NATO-s, Shqipëria e konsideron sigurinë dhe mbrojtjen e saj pjesë të sigurisë dhe mbrojtjes kolektive të Aleancës. Ndërsa misioni kushtetues i FARSH-it mbetet i njëjtë, koncepti i përmbushjes së tij zhvillohet duke sinkronizuar përpjekjet kombëtare me ato të aleatëve. Për të përmbushur këtë mision, FARSH-i planëzojnë, stërviten, pajisen dhe bashkërendojnë veprimtaritë me aleatët qysh në kohë paqeje.

3.3 Objektivat e zhvillimit dhe përdorimit të FARSH-it

Bazuar në mjedisin e sigurisë, parimet e politikës së mbrojtjes dhe objektivat e Shqipërisë në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes, forca e ardhshme do të vijojë të konsolidohet si një forcë profesioniste, me operacionalitet dhe gatishmëri të lartë për përmbushjen me sukses të misionit dhe detyrave, brenda dhe jashtë vendit. Objektivat kryesorë të zhvillimit dhe përdorimit të FARSH-it, janë:

Forcë e aftë dhe shumëmisionëse: Forcat e Armatosura do të zhvillohen si një forcë profesioniste e përforcuar edhe me një komponent rezervist të integruar, me elemente të luftimit dhe të mbështetjes së luftimit, mbi bazën e skenarëve të parashikuar dhe detyrimeve që ka vendi ynë në kuadër të Aleancës. Forca do të jetë e aftë për t'u angazhuar në të gjithë spektrin e detyrave luftarake dhe joluftarake, brenda dhe jashtë vendit, në rajone të njohura e të panjohura, si dhe në çdo lloj moti dhe terreni.

Forcë e bazuar në përparësi: Forcat e Armatosura do të zhvillojnë kapacitetet operationale të

luftimit, të mbështetjes së luftimit dhe të mbështetjes me shërbime të luftimit, veçanërisht ato që nevojiten për mbrojtjen kombëtare, por edhe ato që janë detyrime të vendit tonë në kuadër të procesit të planifikimit të mbrojtjes të NATO-s.

Forcë me sistem të balancuar të shpenzimeve buxhetore: Forcat e Armatosura do të kenë një qasje të balancuar ndaj tri kategorive të buxhetit të mbrojtjes: personel, operacione dhe mirëmbajtje, si dhe investime për modernizimin dhe infrastrukturën. Buxheti i mbrojtjes do të mbështesë dhe motivojë tërheqjen, promovimin dhe mbajtjen e personelit cilësor, duke krijuar njëkohësisht, mundësi për përmirësimin e nivelit të gatishmërisë dhe modernizimin e vazhdueshëm të forcave.

Forcë e bazuar në një grupim të vetëm kapacitetesh: Forcat e Armatosura do të zhvillojnë kapacitete të afta për të përmbushur misionin dhe detyrat, si dhe për të marrë pjesë në operacionet kombëtare dhe ndërkombëtare, në përgjigje të sfidave dhe kërcënimeve që paraqet mjedisi i sigurisë. Për këtë do të zhvillohen kapacitete shumëpërdorimëshe sipas konceptit të një grupimi të vetëm forcash për operacione kombëtare dhe ndërkombëtare, luftarake dhe joluftarake, brenda dhe jashtë vendit, më vete apo të drejtuara nga NATO-ja, BE-ja, OKB-ja apo koalicionet e vullnetit. Zhvillimi i këtyre kapaciteteve do të bazohet në nivelin e ambicies së FARSH-it dhe do të kërkojë rritje në sasinë dhe në cilësinë e FARSH-it dhe kapaciteteve të mbrojtjes.

Forcë e ndërveprueshme: një forcë e përgatitur për të kryer operacione më vete apo të përbashkëta, nën drejtimin e NATO-s, BE-së, OKB-së apo koalicioneve, kërkon një nivel të lartë të ndërveprueshmërisë në planin operacional, doktrinar, taktik, njerëzor, teknik, material e infrastrukturor. Kjo nënkupton jo vetëm ratifikimin dhe zbatimin e STANAG-ëve të rëndësishëm për NATO-n apo ato të përzgjedhura sipas prioriteteve të FARSH-it, por edhe aplikimin praktik të tyre në trajnimet dhe stërvitjet kombëtare dhe ato të përbashkëta me aleatët.

Forcë e motivuar dhe me moral të lartë: personeli do të ngelet pasuria më e madhe dhe elementi më i vyer në FA. Për lartësimin e dinjitetit dhe figurës së ushtarakut, krahas përmirësimit të kushteve për jetesë dhe stërvitje të personelit do të vijojë transformimi dhe rishikimi i kuadrit ligjor për përmirësimin e trajtimit. Fuqia e forcës së ardhshme qëndron te personeli i motivuar, arsimuar, stërvitur dhe pajisur, në përshtatje me rëndësinë dhe natyrën komplekse të misionit. Realizimi i ambicies për rritjen e cilësisë do të sigurohet nëpërmjet motivimit, drejtimit dhe menaxhimit cilësor të personelit krahas trajtimit dhe përkujdesjes.

Forcë me sistem arsimimi bashkëkohor: Republika e Shqipërisë do të zhvillojë një FA të bazuar mbi dijen me një sistem bashkëkohor e dinjitoz edukimi profesional ushtarak, në nivele të krahasueshme me profesionet e tjera dhe FA të vendeve aleate. Kjo do të arrihet nëpërmjet reformimit dhe krijimit të kapaciteteve moderne të arsimimit profesional ushtarak, për të gjitha kategoritë e personelit, në të gjithë spektrin e misionëve, krahas kërkimit shkencor dhe inovacionit në fushën e mbrojtjes. Investimet për kampusin e ri bashkëkohor të AFA-së, përshtatja e kurrikulave, investimet në teknologji dhe në burime njerëzore, do ta bëjnë edukimin profesional ushtarak tërheqës dhe konkurrues me ndikim më pozitiv në rekrutim, motivim dhe zhvillimin e personelit të FARSH-it.

Forcë e integruar dhe plotësuese: sfidat e viteve dhe dekadës së ardhshme do të kërkojnë të rrisim në maksimum rezultatet, talentet dhe sinergjitë e forcave aktive ndërkohë që rezervistët e integruar në forcën aktive, do të caktohen në role dhe detyra të reja, të përcaktuara qartë. Krahas forcave aktive, rezervistët me aftësitë dhe kompetencat e tyre do të shërbejnë si burim alternativ në gjenerimin e forcave për të kryer operacione brenda dhe jashtë vendit.

Forcë me kapacitete moderne: modernizimi do të jetë përparësi për zhvillimin e kapaciteteve për mbrojtjen e vendit dhe përmbushjen e detyrimeve në kuadër të NATO-s, që nevojiten për të garantuar sigurinë dhe mbrojtjen kombëtare dhe kontribuar në sigurinë e paqen rajonale dhe ndërkombëtare. Kjo do të realizohet duke prokuruar kapacitete dhe duke konsideruar teknologjitë e reja, kibernetikën dhe kapacitetet autonome të aktivizuara nga inteligjenca artificiale, për të përshpejtuar vendimmarrjen dhe ritmin operacional, duke zgjeruar gamën, qëndrueshmërinë dhe aftësitë e kapacitetet. Kërcënimet e të ardhmes pritet të vijnë nga keqpërdorimi i teknologjive të reja, prandaj do të bëhemi pjesë e përdorimit ligjor, etik dhe të përgjegjshëm të sistemeve dhe kapaciteteve autonome të mbrojtjes, duke punuar me aleatët dhe partnerët për të formësuar normat dhe standardet rregullatore ndërkombëtare.

Forca e ardhshme do të jetë një forcë moderne me pajisje e sisteme të ndërveprueshme me ato aleate. Standardizimi dhe rinovimi teknologjik do të mundësojnë ndërveprimin midis forcave dhe shërbimeve

dhe me forcat e vendeve të tjera aleate. Përmes bashkëpunimit brenda Aleancës apo në kuadrin e bashkëpunimit dypalësh apo shumëpalësh, veçanërisht me NATO-n dhe BE-në në kuadër të Politikave të Përbashkëta të Mbrojtjes dhe Sigurisë (CSDP), Facilitetit Evropian të Paqes (EPF), si dhe Agjencisë Evropiane të Mbrojtjes (EDA) do të arrihet efektivitet më i lartë në përdorimin e burimeve të mbrojtjes dhe zhvillimin e kapaciteteve me përdorim të shumëfishtë.

Prioritet në modernizim do të kenë projektet për zhvillimin e kapaciteteve të mbrojtjes kundërajrore me bazë në tokë, sistemet e objekteve fluturues pa pilotë dhe sistemet për zbulimin dhe neutralizimin e objekteve fluturues pa pilotë, modernizimi i armatimit, mjetet e transportit dhe ato speciale, mjete ajrore (helikopterë), anije me kapacitete luftarake, si dhe rritja e fuqisë së zjarrit.

Forcë e Armatosur e mbështetur në doktrinë: FARSH-i kanë doktrinën e përbashkët, e cila shërben si udhërrëfyes për përdorimin e tyre. Bazuar në këtë doktrinë, Forcat Tokësore, Ajrore dhe Detare zhvillojnë doktrinat e tyre respektive. Doktrinat ushtarake do të rishikohen bazuar në SSK, SU e RSH-së, Planet Operacionale Kombëtare dhe Planet Rajonale të Aleancës, si dhe në kapacitetet, organizimin, pajisjen dhe gatishmërinë e tyre. Rishikimi i doktrinave do të pasojë SU, duke përcaktuar rrugët se si forcat e bashkuara do të arrijnë objektivat operativë e strategjikë, në mbështetje të qëllimeve kombëtare dhe në kuadër të Aleancës. Zhvillimi i doktrinës do të përfshijë të gjithë ciklin e mësimave të nxjerra nga aplikimi i forcës në luftërat e sotme.

Forcë e pajisur me kapacitete specifike: konfliktet e ardhshme do të kërkojnë kryerjen e operacioneve të shumëllojshme (operacione shumëkomponentësh). Kjo do të kërkojë zhvillimin e një force profesioniste të vogël në sasi, por të aftë të zhvillojë e sinkronizojë përpjekjet përmes të gjitha fushave, funksioneve dhe llojeve të forcave të angazhimit ushtarak në tokë, det, ajër, hapësirë dhe kibernetikë, në bashkëpunim me aleatët në NATO. Kontributi i institucioneve civile në këtë rast është esencial.

Përfaqësim dinjitoz: përfaqësimi ushtarak është element i rëndësishëm i diplomacisë ushtarake. Nëpërmjet përfaqësimit FARSH-i prezanton dhe ekspozon politikën e mbrojtjes dhe sigurisë, në harmonizim dhe bashkëpunim me objektivat e politikës kombëtare të përfaqësuar nga instrumenti i diplomacisë publike. FA-ja do të vijojë të kontribuojë me personel të përzgjedhur dhe profesionist në misionet diplomatike, përfaqësitë ushtarake, shtabet e NATO-s, strukturën e komandës dhe forcës së NATO-s, misionet dhe operacionet e NATO-s, strukturat rajonale të sigurisë dhe ato mbi bazë marrëveshjeve të mirëkuptimit.

Forcë e përbashkët e orientuar nga misioni: FA të RSH-së organizohen, vendosen, përgatiten, pajisen dhe drejtohen sipas konceptit të forcës së përbashkët dhe orientohen nga misioni dhe detyrat. Njësitë e FARSH-it mund të organizohen në trajtën e kapaciteteve modulare të luftimit e të mbështetjes si grupime operacionale për detyrë ("*task force*"), niveli i të cilave do të varet nga detyra dhe natyra e misionit, në të cilat do të angazhohen.

Një sistem i integruar shumëkomponentësh i komandim-kontrollit: Forcat e Armatosura kanë një strukturë dhe sistem të përbashkët dhe të unifikuar komandim-kontrolli, i cili mbështetet në gjeneruesit dhe përdoruesit e forcës. Krijimi, mbajtja në gatishmëri dhe stërvitja e forcave është përgjegjësi e strukturave gjeneruese, ndërkohë që komandimi dhe kontrolli në operacione është përgjegjësi e autoriteteve të përdorimit të forcës. Komandantët e forcave dhe komandave mbështetëse ndihmojnë në koordinimin e operacioneve ku përfshihen dhe janë përgjegjës për zhvillimin e kapaciteteve të reja që nevojiten për përmbushjen e misionit dhe detyrave të tyre.

Digjitalizimi i sistemit kombëtar të komandim-kontrollit, ruajtja dhe mbrojtja e informacionit të klasifikuar, shkëmbimi i tij shpejt vertikalisht mes niveleve të komandim-drejtimit dhe horizontalisht me NATO dhe misionet e saj, mundësimi i operacioneve shumëkomponentëshe (*multidomain operations*), janë aftësi që përbëjnë prioritetet për një komandim-kontroll modern të luftimit të sotëm.

Forcë e gatshme, e dislokueshme dhe e aftë të operojë më vete: në përmbushje të detyrimeve kombëtare dhe atyre në kuadër të Aleancës, FARSH-i do të jenë forca me kapacitete që siguron dislokueshmërinë dhe mëvetësinë. Sistemi i gatishmërisë luftarake të FA-së bazohet në rregulloret kombëtare dhe në detyrimet dhe angazhimet në kuadër të Aleancës. Bazuar në llojin e operacioneve ku marrin pjesë, Forcat e Armatosura mbajnë në regjime të përshkallëzuara gatishmërie kapacitetet e tyre operacionale. Në përcaktimin e sistemit të gatishmërisë luftarake mbahet parasysh koha e lajmërimit për rreziqet konvencionale, si dhe angazhimi i komponentëve të tjerë të fuqisë kombëtare e kolektive para

forcës ushtarake.

Forcë me karakter kombëtar e patriotik: Forcat e Armatosura do të kenë karakter të fortë kombëtar e patriotik, duke qenë një institucion i respektuar në shërbim të kombit dhe duke manifestuar dashuri të palëkundur për atdheun dhe krenari për vendin, vlerat dhe historinë. Të përkushtuar ndaj idealeve kombëtare dhe standardeve më të larta etike, Forcat e Armatosura me moral të lartë dhe ndjenjë të fortë profesionalizmi e disipline, në respekt të institucioneve, ligjeve dhe parimeve demokratike, do të jenë gjithmonë të përkushtuara e të gatshme për të mbrojtur me vetëmohim sovranitetin e kombit.

Forcë që ndjek dhe përshtat sistemin e mbrojtjes kombëtare me atë të NATO-s: NATO-ja është duke ndërmarrë transformimin më të thellë të 30 viteve të fundit, që përfshin riorganizimin total të strukturës së komandimit dhe fuqizimin e aftësive të shkrurajimit dhe mbrojtjes të saj. Ky transformim përfshin edhe arkitekturën e re të familjes së planeve operacionale dhe rishikimin e Strukturës së Forcës së NATO-s në përputhje me Modelin e Ri të Forcave, dhe strukturën e re të komandim-kontrollit. Për vendin tonë ky transformim sjell kërkesa të reja për forcat e deklaruar në NATO, por edhe për ato për përdorim kombëtar, për të qenë më moderne, më të dislokueshme, më të mbështetura dhe më të mbrojtura. Të të njëjtën kohë sjell kërkesa të reja për kapacitete të mbështetjes logjistike, mundësimin të operacioneve, lehtësimin të lëvizshmërisë ushtarake, parapozicionimit të armatimit, municioneve dhe materialeve dhe në tërësi të elementeve të qëndrueshmërisë kombëtare. Për më tepër kërkon aftësi dhe kapacitete më të mëdha për të pritur, transituar dhe lehtësuar lëvizjen e një numri të madh të trupave aleate, nga toka, deti dhe ajri, si dhe sigurimin e mbështetjes së vendit pritës (*Host Nation Support*). Forcat e Armatosura kanë kontribuar në mënyrë aktive në procesin e transformimit në NATO dhe do të ndërmarrin të gjitha hapat e nevojshëm për adoptimin dhe përshtatjen e planeve dhe plotësimin e detyrimeve që ky proces kërkon në bashkëpunim dhe sinkronizim me strukturat përgjegjëse në NATO.

KREU IV

OBJEKTIVAT STRATEGJIKË USHTARAKË, MISIONI, DETYRAT, NIVELI I AMBICIES (NiA) DHE KAPACITETET E FA-së

4.1 Objektivat strategjikë ushtarakë të Republikës së Shqipërisë:

Objektivat strategjikë ushtarakë të Republikës së Shqipërisë rrjedhin nga:

1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë:
 - ruajtja e pavarësisë, sovranitetit dhe tërësisë territoriale të vendit, në bashkëveprim me forcat aleate.
2. Strategjia e Sigurisë Kombëtare (SSK) e Republikës së Shqipërisë:
 - mirëmbajtja e kapaciteteve ekzistuese dhe zhvillimi i aftësive dhe kapaciteteve të reja të nevojshme për funksionimin efikas të sistemit të mbrojtjes;
 - mbrojtja dhe mbështetja e popullsisë në kohë paqeje, krize e lufte;
 - kontributi për mbrojtjen kolektive dhe për paqen dhe sigurinë në rajon e më gjerë;
 - shfrytëzimin racional dhe efektiv të burimeve njerëzore, materiale dhe financiare;
 - rritja e besimit të publikut të FARSH-i dhe sistemit të mbrojtjes.
3. Në kuadër të NATO-s:⁷
 - kontributi në përmbushje të tri detyrave themelore të NATO-s dhe zhvillimi i kapaciteteve dhe aftësive në mbështetje të Familjes së Planeve të NATO-s;
 - përmbushja e kërkesave të Paketës së Objektivave të Kapaciteteve të NATO-s;
 - harmonizimi i planifikimit të mbrojtjes dhe planëzimit operacional me planifikimin e NATO-s;
 - rritja e qëndrueshmërisë kombëtare;
 - kontribut në misione, operacione dhe aktivitete të NATO-s.
4. Angazhime në kuadër të BE-së, OKB-së dhe koalicioneve:
 - kontributi në operacionet dhe misionet e drejtuara nga BE-ja, OKB-ja dhe nga koalicione të vullnetit, në shërbim të sigurisë dhe paqes në rajon edhe më tej;
 - rritja e ndërveprueshmërisë së FA-së me vendet e BE-së do të jetë pararendëse e integritetit dhe në shërbim të agjendës integruese të Republikës së Shqipërisë në BE.
5. Emergjencat civile: FARSH mbështesin autoritetet civile dhe popullsinë civile në raste emergjencash civile me kapacitete sipas nivelit të ambicies.

SSK-ja parashikon rritjen e rolit të Shqipërisë si faktor stabiliteti në rajon, për pasojë FARSH-i do ta përkthejë këtë objektiv në nivel kombëtar në objektiv ushtarak, për të dhënë kontribut në stabilitetin e rajonit, duke rritur prezencën ushtarake në rajon në kuadër të NATO-s dhe BE-së, dhe në bashkëpunim të ngushtë me to. Duke kontribuar për një rajon më të sigurt e të qëndrueshëm FARSH ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në sigurinë e Republikës së Shqipërisë.

Instrumentet për realizimin e këtyre objektivave janë: Hartimi dhe zbatimi i Planit Afatgjatë të Zhvillimit të FARSH (PAZHFA); implementimi i detyrimeve të Paketës së Objektivave të Kapaciteteve; materializimi i strukturës së re të FARSH përfshi edhe komponentin rezervist, si dhe rishikimi i Planeve të mbrojtjes të sinkronizuara me planet e Aleancës.

4.2 Misioni i FARSH-it

Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë sigurojnë pavarësinë e vendit, si dhe mbrojnë tërësinë territoriale dhe rendin e tij kushtetues në Republikën e Shqipërisë⁸. Misioni i Forcave të Armatosura *është ruajtja e pavarësisë, sovranitetit dhe tërësisë territoriale të vendit, në bashkëveprim me forcat aleate, mbrojtja dhe mbështetja e popullsisë në kohë paqeje, krize e lufte, kontributi për mbrojtjen kolektive, në kuadër të nenit 5, të Traktatit të Uashingtonit, si dhe paqen dhe sigurinë në rajon e më gjerë.*

4.3 Detyrat e FARSH-it

Për përmbushjen e misionit të tyre, FARSH-i kryejnë këto detyra:

Në kohë paqeje FA:

- organizohen, trajnohen dhe pajisen për përmbushjen e detyrave në kohë lufte, krize ose sipas ligjit edhe në operacione të emergjencave civile;
- kontrollojnë dhe monitorojnë hapësirën tokësore, ajrore dhe detare të Republikës së Shqipërisë, në bashkëpunim me NATO-n dhe partnerët, me qëllim paralajmërimin e hershëm dhe identifikimin në kohë të rreziqeve të mundshme ndaj sovranitetit dhe integritetit territorial të Republikës së Shqipërisë;
- zhvillojnë kapacitete të ndërveprueshme dhe përgatiten e kontribuojnë në misionet dhe operacione e drejtuara nga NATO-ja, BE-ja, OKB-ja ose koalicionet e vullnetit;
- përgatisin plane për përdorimin e forcës, sipas nivelit të kërkuar të reagimit;
- zgjerojnë spektrin e angazhimeve të tyre, në shërbim të qytetarëve dhe autoriteteve civile;
- përgatiten dhe mbështesin sipas ligjit, autoritetet qendrore e vendore dhe popullsinë në përballimin e emergjencave civile;
- zhvillojnë dhe ofrojnë kapacitete ushtarake speciale, sipas marrëveshjeve ndërinstitucionale;
- parandalojnë dëmtimin dhe mbrojnë mjedisin gjatë veprimtarive ushtarake;
- bashkëpunojnë dhe mbështesin strukturat e sigurisë publike sipas parashikimeve ligjore;

Në kohë krize:

- sigurojnë mbrojtjen e vendit dhe të popullsisë në rast kërcënimesh të jashtme ushtarake;
- kontrollojnë dhe monitorojnë hapësirën tokësore, ajrore dhe detare të Republikës së Shqipërisë, duke përdorur kapacitete të integruara, në bashkëpunim me NATO-n;
- ofrojnë mbështetje si vend pritës për forcat aleate ose për forcat ushtarake të vendeve partnere, të cilat dislokohen në ndihmë të Shqipërisë.
- sigurojnë mbështetjen e nevojshme për eliminimin e efekteve të katastrofave natyrore ose të shkaktuara nga njeriu;
- bashkëpunojnë dhe mbështetnin strukturat e sigurisë publike, siç përcaktohet me ligj;
- koordinojnë dhe bashkëpunojnë me strukturat e tjera brenda dhe jashtë vendit për të parandaluar trafiket e paligjshme, kontrabandën dhe terrorizmin, siç përcaktohet me ligj.

Në kohë lufte:

- planëzojnë dhe kryejnë operacione ushtarake, në mëvetësi dhe në kuadër të mbrojtjes kolektive, për të mbrojtur integritetin territorial të vendit;
- mbrojnë dhe mbështesin popullsinë e Republikës së Shqipërisë;
- kontrollojnë dhe monitorojnë hapësirën tokësore, ajrore dhe detare të Republikës së Shqipërisë, duke përdorur kapacitete të integruara, në bashkëpunim me NATO-n;
- vendosin në gatishmëri forca të trajnuara për angazhim në kuadër të mbrojtjes kolektive të NATO-s;
- sigurojnë mbështetjen si vend pritës dhe transit në territorin e Republikës së Shqipërisë.

4.4 Niveli i ambicies (NiA)⁹ i FARSH-it

NiA rrjedh nga dokumentet strategjike, si SSK-ja dhe nga RSM-ja ku përcaktohen skenarët e mundshëm të rreziqeve ndaj vendit tonë. NiA i FARSH-it përcakton kapacitetet e dëshiruara ushtarake e civile, të cilat FARSH-i i deklaron dhe angazhohet t'i përdorë, për pjesëmarrje të njehershme në operacione kombëtare dhe ndërkombëtare, më vete ose me aleatët.

Në kuadër të mbrojtjes kombëtare, përballimit të emergjencave civile dhe detyrimeve në kuadër të Aleancës, FARSH do të përgatiten të jenë të gatshme dhe të afta për të përballuar kërcënimet dhe rreziqet.

NiA për mbrojtjen kombëtare: NiA për mbrojtjen kombëtare është që FARSH të përmbushin zbatimin e misionit kushtetues për ruajtjen e sovranitetit dhe integritetit të vendit në koordinim dhe bashkëpunim me instrumentet e tjera të fuqisë kombëtare.

Për të përmbushur në mënyrë më efektive misionin dhe objektivat e sigurisë kombëtare do të zhvillojnë kapacitetet për t'iu përgjigjur sulmeve të armatosura. Fokusi do të jetë në zhvillimin e kapaciteteve në kuadër të mbrojtjes kombëtare.

Kapacitetet që i duhen FA-së për t'iu përgjigjur të gjithë spektrit të kërcënimeve dhe rreziqeve ndaj vendit, janë kapacitetet për mbrojtjen e territorit nga agresioni i mundshëm konvencional dhe neutralizimin e kërcënimeve hibride.

NATO-ja dhe marrëdhëniet me SHBA-në dhe BE-në mbeten themeli i sigurisë së Republikës së Shqipërisë. Ndërveprimi dhe integrimi me aleatët do të jetë element thelbësor për të kontribuar në mbrojtjen kombëtare.

NiA për mbrojtjen kombëtare është zhvillimi i operacioneve të përbashkëta me komponentët tokësor, detar, ajror dhe atë mbështetës në nivelin strategjik, operacional dhe taktik në të gjithë spektrin e operacioneve dhe në bashkëpunim me Aleancën¹⁰.

NiA për përballimin e emergjencave civile: angazhimi për përballimin e emergjencave civile brenda vendit është pjesë e misionit kushtetues të Forcave të Armatosura. FARSH mbajnë dhe trajnojnë kapacitete kombëtare specifike për angazhimin në rast emergjencash civile në bashkëpunim me institucionet e ngarkuara me ligj për përballimin e tyre. Kjo mbështetje për autoritetet civile qendrore dhe lokale kryhet kur kapacitetet e tyre janë të pamjaftueshme apo kur FARSH sjellin ekspertizë që nuk disponohet nga institucionet e tjera përgjegjëse.

NiA për pjesëmarrje në operacione për përballimin e emergjencave civile brenda vendit është në varësi të rëndesës së situatës e emergjencës së shkaktuar. Përcaktimet e kapaciteteve përkatëse specifikohen në Planin Kombëtar të Emergjencave Civile.

NiA në kuadër të NATO-s: FARSH-i merr pjesë në operacionet luftarake të drejtuara nga NATO-ja, në përputhje me angazhimet e marra në kuadër të shkurajimit dhe mbrojtjes. Ky angazhim mbështetet te realizimi i objektivave të kapaciteteve, sipas afateve dhe gatishmërisë së kërkuar nga Aleanca dhe dakordësuar nga Republika e Shqipërisë.

NATO-ja mbetet themeli i sigurisë në rajonin tonë dhe atë euroatlantik. Republika e Shqipërisë do të vazhdojë të jetë aleat i besueshëm, duke shtuar përpjekjet për të transformuar dhe modernizuar forcat tona të armatosura si në fushat klasike operationale (tokë, ajër dhe det) dhe në hapësirën kibernetike.

Republika e Shqipërisë mbetet e palëkundur në angazhimet e saj në mbrojtjen kolektive, për përmbushjen e detyrimeve sipas Familjes së Planeve të Aleancës dhe në sigurimin e mbrojtjes së Rajonit të Përgjegjësisë së Aleancës me forca dhe kohëzgjatje sipas deklarimeve dhe planeve përkatëse.

NiA i FARSH-it për pjesëmarrje në operacionet e zhvilluara dhe drejtuara nga Aleanca është sipas përcaktimeve në dokumentet respektive të mbrojtjes.

Për të përmbushur angazhimet e marra në Aleancë do të zhvillohen dhe deklarohen sipas niveleve të gatishmërisë kapacitetet e FA-së, në përputhje me angazhimet tona ndaj Nismës së Gatishmërisë së NATO-s dhe Procesit të Planifikimit të Mbrojtjes së NATO-s.

Në të njëjtën kohë do të synohet vijimi i kontributit me kapacitete të specializuara *Niche*.

NiA për pjesëmarrje në operacionet dhe misionet e drejtuara nga BE-ja: FARSH-i do të marrë pjesë dhe kontribuojë në misionet ushtarake të BE-së, në kuadër të Politikës së Përbashkët të Sigurisë dhe Mbrojtjes së BE, me të cilin ndan mjedisin gjeostrategjik dhe përballet me sfida, rreziqe e kërcënime të përbashkëta të sigurisë. Në kuadër të vijimit të procesit të integritetit të vendit tonë me BE-në dhe integritetit në Politikën e Përbashkët të Sigurisë dhe Mbrojtjes do të vijnë pjesëmarrjen në misionet dhe operacionet e drejtuara nga BE-ja, me trupa, oficerë shtabi dhe me kapacitete *Niche*, si EOD apo ekspertë trajnues, këshillues dhe ndihmues.

NIA për pjesëmarrje në operacionet dhe misionet e drejtuara nga OKB-ja: krahas kontributeve më lart, FARSH angazhohen të kontribuojnë në misionet dhe operacionet e drejtuara nga OKB-ja, me trupa, oficerë shtabi dhe me kapacitete *Niche*.

4.5 Kapacitetet e FARSH-it

Siguria e vendit është një çështje e të gjithëve, qofshin individë apo aktorë shtetërorë. Ajo është e lidhur me sistemin e mbrojtjes kolektive të Aleancës dhe planet e modernizimit do të konsiderojnë ndërtimin e kapaciteteve me përdorim të dyfishtë dhe të shumëfishtë për vendin, NATO-n, BE-në, ose për aleancat strategjike. Për këtë Forcat e Armatosura do të zhvillojnë kapacitete të përshtatshme për t'iu përgjigjur të gjithë spektrit të rreziqeve ndaj vendit, si dhe në përmbushje të angazhimeve kombëtare dhe ndërkombëtare.

Ndryshimi i situatës së sigurisë në Evropë, sfidat e rritura në kufirin lindor dhe në kufirin jugor të Aleancës, kërkon jo vetëm përmbushjen e angazhimeve në kuadër të Aleancës, por edhe zhvillimin e kapaciteteve që i shërbejnë interesave kombëtare dhe përballimit të rreziqeve dhe kërcënimeve konvencionale dhe jokonvencionale.

Kapacitetet e FARSH-it ndahen në kapacitete të luftimit, kapacitete të mbështetjes (kapacitete të mbështetjes së luftimit dhe ato të mbështetjes me shërbime të luftimit).

a) Kapacitetet e luftimit

Kapacitetet e luftimit përfaqësojnë aftësitë e FARSH-it për të kryer operacione luftarake dhe joluftarake në plotësim të misionit. Ato realizohen prej njësisë të luftimit, të cilat organizohen, stërviten dhe pajisen për të qenë të gatshme për zhvillimin e operacioneve luftarake dhe joluftarake, brenda dhe jashtë vendit.

Në vijim të përmbushjes së detyrimeve ndaj NATO-s, prioritet i modernizimit do të jetë zhvillimi dhe rritja e aftësive operacionale të FA-së, me fokus zhvillimin më tej të kapaciteteve të Grup-Batalionit të Këmbësisë së Lehtë dhe Forcave Speciale (SOLTG), duke vijuar kompletimin me armatim, municion dhe pajisje komunikimi, krahas rritjes së kapaciteteve të lëvizshmërisë, manovrueshmërisë dhe mbrojtjes së trupave, rritjen e kapaciteteve të fuqisë së zjarrit dhe arritjen e kapaciteteve të plota operacionale të strukturës aktuale dhe komponentit rezervist.

b) Kapacitetet e mbështetjes së luftimit

Kapacitetet e mbështetjes përfaqësojnë aftësitë e FARSH-it për të mbështetur operacionet luftarake dhe joluftarake në plotësim të misionit. Ato realizohen nga njësitë e mbështetjes së luftimit dhe njësitë e mbështetjes me shërbime të luftimit. Kapacitetet e mbështetjes së luftimit ngelen të rëndësishme, pasi iu ofrojnë ndihmë operacionale elementeve të luftimit.

Në vitet dhe dekadën e ardhshme FARSH-i do të zhvillojë kapacitetet e mbështetjes së luftimit me kapacitetet e mbrojtjes ajrore dhe sistemet e mjeteve fluturuese pa pilotë dhe sistemet kundër mjeteve fluturuese pa pilotë, për mbrojtjen e popullsisë, infrastrukturës kritike kombëtare dhe instalimeve ushtarake. Po ashtu do të vijojë zhvillimi i kapaciteteve të fuqisë së zjarrit, sistemet kundërtanke, krahas kapaciteteve statike dhe të lëvizshme të informacionit, komandim-kontrollit dhe komunikimit dhe kapacitetet e dislokueshme të mbrojtjes kibernetike, kapaciteteve të inteligjencës dhe sigurisë, si dhe zhvillimin e kapaciteteve të xhenios luftuese dhe EOD, kapaciteteve të mbrojtjes kundërtanke dhe të MADM-së.

Forca Ajrore do të vijojë projektin për pajisjen me mjete ajrore helikopterë ushtarakë të transportit të mesëm për të rritur kapacitetet dhe efektshmërinë dhe eficiencën e mbajtjes dhe zhvillimit të këtij kapaciteti. Këta helikopterë do të jenë helikopterët bazë shumërolesh, për t'u përdorur në operacione brenda vendit, në operacionet e NATO-s, në mbështetje të autoriteteve civile apo në operacionet SAR dhe të emergjencave civile.

c) Kapacitetet e mbështetjes me shërbime të luftimit

Kapacitetet e mbështetjes me shërbime të luftimit do të sigurojnë mbështetjen e përgjithshme kryesisht në fushën logjistike për të gjithë FARSH. Për zhvillimin e këtyre kapaciteteve do të investohet në kapacitetet dhe mjetet e furnizimit dhe transportit, kapacitetet e mirëmbajtjes së armatimit, pajisjeve dhe mjeteve tokësore, detare dhe ajrore, kujdesit shëndetësor, kujdesit psikologjik dhe të administrimit. Për zhvillimin profesional të personelit do të sigurohen kapacitetet e arsimimit, kërkimit shkencor, trajnimit dhe stërvitjeve.

4.6 Struktura dhe organizimi i FARSH-it

Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë përbëhen nga Forca Tokësore, Detare, Ajrore, strukturat mbështetëse, përfshirë edhe komponentin rezervist si pjesë integrale e tyre. Forcat e Armatosura organizohen dhe funksionojnë si një strukturë e bashkuar e kapaciteteve të forcave tokësore, detare, ajrore dhe atyre mbështetëse, për të realizuar me efektivitet misionin.

Miratimi i strukturës së FARSH-it dhe Planvendosjes së përhershme bëhet sipas linjës së hierarkisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Struktura organizative e Forcave të Armatosura do të jetë në rishikim të vazhdueshëm, për t'u përshtatur me procesin e modernizimit dhe zhvillimit të kapaciteteve, por edhe kërcënimeve dhe sfidave të mjedisit të sigurisë dhe përmbushjes së misionit e detyrave.

Në FARSH do të implementohet komponenti rezervist tërësisht i integruar me komponentin aktiv, sipas mundësive dhe kushteve të vendit dhe shoqërisë sonë. Ky komponent do të jetë shumë i rëndësishëm për gjenerimin e forcës në operacione dhe për zgjerimin e prezencës së forcës aktive.

Organizimi i FARSH-it: organizimi strukturor i Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë realizohet sipas një sistemi linear hierarkik, i cili siguron komandim-kontrollin e unifikuar të FARSH-it. FARSH-i përbëhen nga Forcat Tokësore, Detare dhe Ajrore dhe strukturat mbështetëse. Në krye të FARSH-it qëndron Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura dhe në krye të forcave respektive dhe strukturave mbështetëse qëndrojnë komandantët, të cilët mbështeten nga shtabe ose struktura ndihmëse në ushtrimin e autoritetit komandues.

Strukturat e FARSH-it mund të veprojnë më vete ose të organizuara si një forcë e organizuar për detyrë sipas misionit dhe detyrës specifike, e pajisur me kapacitetet e domosdoshme, e përgatitur, në gatishmëri dhe e aftë për të përmbushur detyrën.

Strukturat e FARSH-it, në interes të realizimit të misionit dhe funksionimit të tyre, janë të vendosura në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, sipas një plani vendosjeje të miratuar nga autoritetet e përcaktuara me ligj të veçantë.

Shtabi i Përgjithshëm i FARSH-it: Shtabi i Përgjithshëm i FARSH-it është struktura organizative më e lartë ushtarake në Forcat e Armatosura. Misioni i Shtabit të Përgjithshëm është planifikimi, zhvillimi e komandim-kontrolli strategjik i Forcave të Armatosura, me komponentin tokësor, detar e ajror, si dhe strukturat e tjera mbështetëse, të afta për të plotësuar misionin e tyre kushtetues.

Komandat kryesore të FARSH-it: sipas organizimit, komandat kryesore të FARSH-it përbëhen nga Komanda e Forcës Tokësore, së bashku me strukturat e vartësisë, Komanda e Forcës Detare, së bashku me strukturat e vartësisë, Komanda e Forcës Ajrore, së bashku me strukturat e vartësisë, dhe Komandat e Strukturave Mbështetëse, të cilat përfshihen Komanda Mbështetëse (KM) dhe Akademia e Forcave të Armatosura (AFA), së bashku me strukturat e vartësisë së tyre, si dhe Kolegji i Mbrojtjes dhe Sigurisë. Komandat dhe strukturat e vartësisë organizohen, trajnohen dhe pajisen për realizimin e misionit dhe detyrave në kohë paqeje, krize dhe lufte.

Strukturat e drejtimit dhe komandim-kontrollit dhe parimet bazë: drejtimi i FARSH-it në nivelin politiko-strategjik ushtrohet nga Kuvendi i Shqipërisë, Presidenti i Republikës, Kryeministri dhe ministri i Mbrojtjes, të specifikuara me ligj të veçantë.

Komandim-kontrolli në nivelin ushtarako-strategjik në kohë paqe ushtrohet nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

Komandim-kontrolli operacional i FARSH-it, në kohë paqeje, realizohet nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm i FARSH-it, ndërsa në kohë lufte nga Komandanti i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura.

Drejtimi dhe komandim-kontrolli operacional mbështetet në këto parime bazë: kontrolli civil i FARSH-it, paanshmëria politike e FARSH-it, komandim i unifikuar i FARSH-it dhe zbatimi i hierarkisë në zinxhirin e komandimit.

KREU V

MBËSHTETJA ME BURIME TË MBROJTJES E FARSH-it

Burimet e mbrojtjes përfshijnë të gjitha asetet njerëzore, materiale dhe financiare, në dispozicion të FA-së për të realizuar misionin dhe detyrimet në kuadrin e mbrojtjes kolektive.

Planifikimi i burimeve të mbrojtjes do të krijojë kushtet për shfrytëzimin me efikasitet të tyre sipas Planit Afatgjatë të Zhvillimit të FARSH-it (PAZH), Listës së Integruar të Prioriteteve (LIP), si dhe Sistemit të Planifikimit, Programimit, Buxhetimit dhe Ekzekutimit të Mbrojtjes (PPBE).

5.1 Burimet njerëzore dhe konsolidimi i forcës profesioniste

Burimet njerëzore janë pjesa më e rëndësishme dhe më aktive e burimeve të Mbrojtjes, në të cilët përfshihen ushtarakët aktivë e në rezervë, si dhe punonjësit civilë të FARSH-it. Numri i personelit aktiv të FARSH-it do të jetë 8500 pjesëtarë aktivë dhe 2100 rezervistë, nëse kushtet dhe mjedisi i sigurisë nuk kërkojnë rritjen e tij. Zhvillimi i burimeve njerëzore do të synojë arritjen e një force cilësore të motivuar, të trajnuar, të pajisur dhe të ndërveprueshme me forcat aleate.

Për t'i konsoliduar më tej burimet njerëzore në funksion të detyrimeve kushtetuese dhe atyre në kuadër të NATO-s, është miratuar koncepti rezervist i FARSH-it, ku përcaktohet integrimi i forcës rezerviste me strukturat aktive të FA-së.

Të vetëdijshëm për sakrificat dhe kërkesat unike të shërbimit dhe jetës së ushtarakëve, personeli i FARSH-it, aktiv dhe në rezervë, do të mbështetet në mënyrë të vazhdueshme, nëpërmjet rishikimit periodik të kuadrit ligjor, përmirësimit të pagës dhe trajtimit, rishikimit të trajtimit për vështirësi dhe kushte të veçanta të punës e shërbimit. Kjo do të promovojë zhvillimin e forcës profesioniste duke garantuar njëkohësisht shanse të barabarta për të gjithë qytetarët e Republikës së Shqipërisë, si dhe trajtim dinjitoz të tyre, gjatë gjithë karrierës dhe pas saj.

Menaxhimi i burimeve njerëzore, mbështetur në aktet ligjore, nënligjore, politikat, strategjitë dhe procedurat, do të rregullojë veprimtarinë e tyre në të gjithë ciklin jetësor të personelit: rekrutim, arsimim dhe trajnim, promovim në gradë dhe karrierë, si dhe periudha pas daljes në lirim (rezervë dhe në pension). Synimi është që FA-ja të jetë konkurrent me tregun civil të punës.

Forcat e Armatosura përfaqësojnë një element kyç të identitetit tonë kombëtar, po aq me rëndësi është edhe përfaqësimi i të gjithë vendit dhe shoqërisë në FA. Do të rishikohet dhe do të përmirësohet në vijimësi procesi dhe strategjia e rekrutimit, duke i çuar Forcat e Armatosura te publiku dhe lidhur më fort me popullin dhe pushtetin lokal. Synimi do të jetë rekrutimi në raporte të drejta përfaqësimi gjinor dhe rritja e cilësisë në rekrutimin e kandidatëve që dëshirojnë të shërbejnë në radhët e FA-së.

Me qëllim që të tërheqim dhe të mbajmë njerëzit më të talentuar, të rejave dhe të rinjve që do t'i bashkohen radhëve të FA-së do t'i ofrohet arsimim cilësor dhe bashkëkohor, promovim në karrierë, si dhe trajtim konkurrues me tregun civil. Fokusi do të jetë në transparencën dhe menaxhimin e karrierës përmes aplikacioneve digjitale për një qasje transparente dhe të unifikuar në të gjithë mbrojtjen.

5.2 Modernizimi

FARSH do të sigurojnë dhe rrisin kapacitetet e tyre operationale nëpërmjet modernizimit të sistemeve dhe pajisjeve të tyre, për të garantuar mbrojtjen kombëtare dhe për të përmbushur detyrimet në kuadër të mbrojtjes kolektive. Në këtë mënyrë FARSH janë të përgatitur për t'iu përgjigjur kërkesave të paketës së re të Objektivave të Kapaciteteve të cilat priten të jenë akoma më ambicioze. Fokusi kryesor do të jetë modernizimi i sistemeve të mbrojtjes kundër dronëve (C-UAS), mbrojtjes ajrore me sisteme me rreze të shkurtër veprimi (V-SHORAD), si dhe sistemeve të mbrojtjes me rreze të mesme veprimi (M-RAD). Grup-Batalioni i Lehtë i Këmbësisë (LIBG) do të kompletohet me sisteme të zjarrit, lëvizshmërisë dhe mbrojtjes së personelit. Forca Ajrore do të kompletohet me helikopterë shumërolësh, për të kryer operatione shumëdimensionale (multidomain) të një spektri të gjerë, si dhe do të modernizohet Baza Ajrore e NATO-s në Kuçovë me sisteme të kontrollit dhe komunikimit.

Pjesë e këtij procesi do të jetë modernizimi i sistemeve dhe pajisjeve për të gjitha llojet e armëve dhe shërbimeve, përfshi sistemet e monitorimit të hapësirës detare dhe ajrore, flotën e automjeteve të transportit ushtarak, kapacitetet për mbrojtjen kibernetike dhe emergjencat civile.

Në përputhje me direktivën e NATO-s për rritjen e kapaciteteve të industrisë ushtarake për të siguruar pavarësi në interes të mbrojtjes kombëtare dhe asaj kolektive, një fokus të veçantë do të ketë dhe rikthimi në jetë i industrisë ushtarake të mbrojtjes dhe modernizimi i saj. Ky proces, krahas të tjerash, do të përfshijë modernizimin e pajisjeve për prodhimin e municioneve të kalibrave të ndryshëm, lëndeve plasëse, modernizimin e sistemeve dhe pajisjeve për riparim dhe mirëmbajtje, si dhe të infrastrukturës së tyre.

5.3 Burimet materiale dhe mbështetja me shërbime

Burimet materiale përbëjnë elementin tjetër thelbësor për funksionimin dhe përdorimin me efikasitet të Forcave të Armatosura, në kohë paqe, krize dhe lufte. Ato përfshijnë sistemet, pajisjet, mjetet e luftimit dhe të mbështetjes, veshmbathjen, si dhe të gjitha produktet që i nevojiten Forcave të Armatosura për të kryer misionin dhe detyrat e tyre. FARSH-i do të vijojnë të kompletohen me sisteme, pajisje dhe mjete

bashkëkohore në përputhje me politikat, prioritetet dhe planet e modernizimit, të harmonizuara me NATO-n. Në këtë mënyrë mundësohet mbështetja e nevojshme materiale dhe me shërbime, sipas standardeve për të gjitha fushat, si dhe mëvetësia operationale për strukturat sipas angazhimeve.

Mundësimi (*enablement*) i kryerjes së spektrit të operationeve ushtarake kombëtare apo në kuadër të ekzekutimit të Planeve të Mbrojtjes së Aleancës, do të realizohet nëpërmjet sigurimit të burimeve materiale dhe mbështetjes logjistike, zhvillimit të infrastrukturës së transportit, dislokimit dhe mbështetjes, parapozicionimit të materialeve qysh në kohë paqeje dhe zhvillimit të mëtejshëm të koncepteve të logjistikës kolektive dhe mbështetjes të vendit pritës. Mundësimi i burimeve logjistike në mbështetje të operationeve ushtarake do të trajtohet me prioritet dhe me qasje gjithëinstitucionale.

5.4 Infrastruktura

Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë do të administrojnë, zhvillojnë dhe mirëmbajnë një infrastrukturë të mjaftueshme e bashkëkohore për jetesë, stërvitje e komandim-kontroll të njërive dhe reparteve, për realizimin e misionit dhe detyrave të tyre në kohë paqeje, krize e lufte.

Zhvillimi infrastrukturor do të arrihet nëpërmjet investimeve në garnizonet kryesore, repartet, rajonet stërvitore dhe poligonet kombëtare, me synim ndërtimin e objekteve të reja dhe riparimin apo përshtatjen e atyre ekzistuese, sipas standardeve bashkëkohore. Synimi është përmirësimi i kushteve për punë, jetesë, arsimim dhe stërvitje.

Prioritet në infrastrukturë do të kenë investimet për përmirësimin e infrastrukturës dhe përfundimi i zbatimit të projektit të Bazës Ajrore të Kuçovës, si dhe vënia në shfrytëzim e saj, si një bazë ajrore taktike e NATO-s, zhvillimi i projektit të ndërtimit të portit ushtarak të Porto-Romano, ndërtimi dhe vënia në shfrytëzim e kampusit të ri të AFA-së, zhvillimi i poligonit kombëtar në Pajet dhe Mnellë, përmirësimi i infrastrukturës në garnizonet kryesore, ndërtimi i depove të armatimit e municioneve dhe depot e karburanteve, hangarët e helikopterëve të rinj, si dhe zhvillimit të kapaciteteve të vendit pritës.

Planvendosja e përhershme: përcakton vendndodhjen e shtabeve, njërive dhe reparteve ku ushtrohet komandimi dhe drejtimi i Forcave të Armatosura, përgatitja, trajnimi (rajonet stërvitore, poligonet) dhe edukimi i tyre. Planvendosja përfshin edhe bazat ushtarake të deklaruara për NATO-n. Vendvendosjet e përhershme të FARSH-it përcaktohen me dekret të Presidentit të Republikës së Shqipërisë dhe ato do të vijojnë në gjurmën e vendosjes aktuale të cilat do të rishikohen pas miratimit të SU.

Rezerva logjistike do të luajë një rol kyç në realizimin e misionit dhe detyrave. Sigurimi dhe mbajtja e rezervës logjistike do të bëhet duke u bazuar në sistemin e gatishmërisë, operationeve dhe stërvitjes së FARSH-it, si dhe sipas konceptit të mbështetjes logjistike kolektive NATO-s, duke përfshirë të gjitha fushat e mbështetjes me shërbime dhe të gjitha klasat e furnizimit.

5.5 Burimet financiare

Burimet financiare për sigurimin e shpenzimeve të mbrojtjes dhe përmbushjen e detyrimeve në kuadër të mbrojtjes kolektive, sigurohen nga buxheti i mbrojtjes, buxheti i përbashkët i Aleancës, si dhe nga programet e bashkëpunimit ushtarak dypalësh. Duke qenë se FARSH-i ka nevoja në rritje për burime financiare, krijimi i kapaciteteve do të fokusohet në prioritetet të mirë përcaktuara, me një menaxhim më të mirë, transparent dhe efikas të financave.

Për të përballuar sfidat aktuale të mjedisit të sigurisë dhe ato që priten prej zhvillimeve teknologjike, vendet kanë vendosur të rrisin investimet në mbrojtje dhe mbajtur hapin me shkallën dhe kompleksitetin e ndryshimeve dhe zhvillimeve teknologjike. Duke qenë se siguria e Aleancës është e lidhur me sigurinë e vendit tonë, do të përmbushen detyrimet për barrën financiare, do të zhvillohen aftësitë dhe kapacitetet për të menaxhuar një gamë të gjerë krizash, si dhe do të rritet kontributi në operationet dhe misionet e NATO-s.

Për të garantuar përmbushjen e misionit kushtetues dhe arrijtjen e objektivave strategjike kjo strategji mbështet një buxhet të mbrojtjes në nivelet e kërkuara. Në përmbushje të detyrimeve nën nenin 3 të Traktatit të Uashingtonit dhe në zbatim të vendimit të marrë nga krerët e vendeve aleate në Samitin e NATO-s në Vilnius 2023, do të synohet që buxheti i mbrojtjes të jetë jo më pak se dy për qind i prodhimit të brendshëm bruto¹¹ dhe shpenzimet për investime dhe pajisje e armatime të jenë në 20 për qind të buxhetit të Mbrojtjes, sikurse është pranuar edhe në Deklaratën e Samitit të Uellsit.

Përdorimi i burimeve të Mbrojtjes në FA do të bëhet në mënyrë të balancuar ndërmjet tri kategorive kryesore të shpenzimeve (personeli, operationet dhe mirëmbajtja, si dhe investimet për modernizimin

dhe infrastrukturën), për të siguruar zhvillim harmonik e të integruar të të gjitha fushave të mbrojtjes.

5.6 Mbështetja në kuadrin e bashkëpunimit ushtarak

Mbështetja në kuadrin e bashkëpunimit ushtarak do të synojë programe dhe projekte në funksion të rritjes së kapaciteteve dhe përmbushjes së kërkesave të paketës së objektivave të kapaciteteve. Krahas arsimit dhe trajnimit të personelit dhe stërvitjeve e vlerësimit të njësive të FA-së, prioritet do të jetë rritja e cilësisë së përfaqësimit dhe mbështetja e kontributeve në misionet dhe operacionet e drejtuara nga NATO/BE/OKB.

Vendi ynë, si anëtar i NATO-s, do t'i japë rëndësi parësore bashkëpunimit nën këtë ombrellë. NATO-ja ofron një kornizë të gjerë bashkëpunimi me ekspertizën më të mirë, duke filluar nga planifikimi i kapaciteteve të mbrojtjes deri te tendencat e reja të përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike, evolucionet në teknologji, hapësirë dhe kibernetikë. Qasja jonë brenda NATO-s do të orientohet nga zhvillimi i një force të përbashkët, me strukturë funksionale dhe të unikifikuar komandim-kontrolli dhe struktura fleksibël të forcës, me gatishmëri të lartë operationale, doktrina, aftësi dhe kapacitete të ndërveprueshme me Aleancën, për pjesëmarrje në operacione, në kuadër të mbrojtjes kolektive apo për menaxhimin e krizave.

Pjesëmarrja në operacionet e NATO-s do të vijojë duke rritur nivelin e angazhimit të FA-së. Prioritet do të jetë kontributi në misionin e NATO-s në Kosovë (KFOR). Njëkohësisht do të vijojë kontributi përgjatë kufirit lindor dhe jugor të NATO-s, apo ku nevoja e së ardhmes do ta kërkojë, aktivitetet detare të Aleancës dhe stërvitjet e përbashkëta me aleatët tanë. FA do të mbeten të përkushtuar për të zhvilluar kapacitetet dhe për të punuar me partnerët për të adresuar edhe terrorizmin përfshirë atë kibernetik, njësoj si kërcënimet e tjera ndaj vendit tonë dhe ndaj NATO-s.

Bashkëpunimi në kuadër të NATO-s nuk e përjashton, por e nxit bashkëpunimin dypalësh me aleatë dhe partnerë të rëndësishëm, pasi me ta ndajmë një gamë të gjerë interesash për sigurinë e vendit, rajonit dhe NATO-s. Bashkëpunimi dypalësh me këta aleatë mbetet i rëndësishëm për zhvillimin e kapaciteteve dhe dislokimin e pjesëmarrjen në misione dhe operacione brenda dhe jashtë zonës euroatlantike.

FARSH-i ka gjeneruar mësim të nxjerra të vlefshme nga eksperiencat në operacione në kuadër të NATO-s dhe në operacione të përbashkëta me vende aleate. Këto eksperiencë, por sidomos lufta aktuale Rusi-Ukrainë, do të reflektohen në rishikimin e standardeve, doktrinave dhe procedurave, si dhe përdorimin e tyre në përgatitjen dhe stërvitjen e trupave.

Republika e Shqipërisë dhe SHBA-ja janë aleatë dhe partnerë të pandashëm për sigurinë dhe mbrojtjen. Bashkëpunimi i mbrojtjes me SHBA-në, është bashkëpunimi më i gjerë dhe më i avancuar që kemi me vendet aleate dhe partnere, bazuar në vlerat dhe interesat e përbashkëta për ruajtjen e paqes dhe sigurisë në rajon e më gjerë, i shtrirë në të gjithë spektrin e mbrojtjes, duke përfshirë inteligjencën dhe kibernetikën, bashkëpunimin për modernizimin dhe zhvillimin e kapaciteteve, edukimin dhe trajnimin, stërvitjen dhe gatishmërinë. Ky bashkëpunim do të thellohet dhe do të punojmë së bashku për të forcuar më tej marrëdhëniet dypalëshe dhe aleancën e NATO-s.

Bashkëpunimi me Kosovën mbetet thelbësor për qasjen tonë për sigurinë dhe paqen pasi ndajmë të njëjtat interesa kombëtare dhe kërcënime, sfida dhe mundësi të përbashkëta. Bashkëpunimi me FSK-në do të jetë i pakufizuar në të gjitha hapësirat operationale dhe në të gjitha domenet. Më tepër se kaq, bashkëpunimi do të shtrihet në analizat strategjike, zhvillimin e kapaciteteve, ndërveprueshmërinë dhe koordinimin operacional. Ne do të vazhdojmë të angazhohemi në të gjitha nivelet, për t'u siguruar që do të ofrojmë gjithçka dhe mbështetur njëri-tjetrin në trajtimin e sfidave të sigurisë në rajon.

Si vend kandidat për anëtarësim në BE, mbetemi të përkushtuar për të punuar me BE-në dhe me partnerët e aleatët evropianë, dhe për të investuar në sigurinë dhe prosperitetin evropian. Ne do të punojmë së bashku, ku përputhen interesat tona, për të kundërshtuar dhe penguar influencat e huaja dhe për t'u mbrojtur kundër kërcënimeve të përbashkëta të sigurisë. Ndërkohë që NATO-ja do të mbetet forumi ynë kryesor për angazhimin mbi sigurinë evropiane, ne do të intensifikojmë marrëdhëniet dypalëshe me BE-në dhe me vendet e BE-së dhe do të rrisim angazhimin dhe kontributet tona në misionet dhe operacionet e BE-së.

Përfundime

Strategjia Ushtarake e Republikës së Shqipërisë rifokuson përpjekjet e FARSH-it në misionin e tyre kushtetues. Ajo na orienton si të mendojmë, të organizohemi, të trajnohemi, të pajisemi dhe si të

ndërveprojmë në një mjedis dhe kontekst të ndryshuar, dhe në ndërveprim me të gjitha elementet e fuqisë shtetërore për të mbrojtur interesat kombëtare, për të përmbushur misionin kushtetues të FARSH-it dhe detyrimet në kuadër të Aleancës.

Ky dokument strategjik bazohet në kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe mbështet ambiciet dhe detyrimet që rrjedhin nga SSK-ja. Gjithashtu, ajo është në harmoni me vlerat dhe parimet demokratike dhe reflekton Strategjinë Ushtarake dhe Konceptin Strategjik të NATO-s, vendimet e marra në samitet e Aleancës, si dhe koncepteve të DDA-së dhe NWCC-së.

Strategjia Ushtarake identifikon si prioritet gatishmërinë e FA-së me kapacitetet dhe aftësitë e kërkuara për të mbrojtur sovranitetin dhe integritetin e Republikës së Shqipërisë dhe qytetarëve të saj nga kërcënimet dhe rreziqet e mundshme.

Gjithashtu, Strategjia Ushtarake ofron udhëzime për zhvillimin e forcës së ardhshme, të aftë e të ndërveprueshme, për të kontribuar në sigurinë kolektive të Aleancës dhe sigurinë rajonale e më gjerë, duke marrë pjesë në misionet dhe operacionet ndërkombëtare në kuadër të NATO-s, BE-së dhe OKB-së apo në operacionet humanitare dhe të emergjencave civile, brenda dhe jashtë vendit.

Përmbushja e objektivave të mbrojtjes kërkon mbështetjen e gjerë të publikut, politikës dhe institucioneve. Zbatimi i Strategjisë Ushtarake kërkon bashkëpunimin e ngushtë me institucionet qeveritare dhe aktorëve ushtarakë e civilë të sistemit të sigurisë dhe mbrojtjes. Kjo strategji do të mbështetet me plane e programe për zhvillimin e kapaciteteve të nevojshme dhe për vënien e saj në praktikë.

Ky dokument do të rishikohet në mënyrë periodike çdo pesë vjet ose kur ka ndryshime në mjedisin e sigurisë që e bëjnë rishikimin e tij të domosdoshëm.

Shkurtime

AFA	Akademia e Forcave të Armatosura
BE	Bashkimi Evropian
CSDP	Politikat e përbashkëta të mbrojtjes
DDA	Koncepti i NATO-s për Shkruajim dhe Mbrojtje të Zonës Euroatlantike (<i>Deterrence and Defence of the Euro-Atlantic Area</i>)
EDA	Agjencia Evropiane e Mbrojtjes e Sigurisë
EPF	Faciliteti Evropian i Paqes
FA	Forcat e Armatosura
FARSH	Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë
KFOR	Misioni i NATO-s në Kosovë
MM	Ministria e Mbrojtjes
NWCC	Koncepti Themelor i Zhvillimit të Luftimit të NATO-s (<i>NATO Warfighting Capstone Concept</i>)
NATO	Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut
NiA	Niveli i ambicies
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
PAZH	Plani Afatgjatë i Zhvillimit
PBB	Prodhimi i brendshëm bruto
RSH	Republika e Shqipërisë
SSK	Strategjia e Sigurisë Kombëtare
STANAG	Marrëveshje Standardizimi e Aleancës
SU	Strategjia Ushtarake
RSM	Rishikimi Strategjik i Mbrojtjes

Referenca:

¹ Koncepti i ri Strategjik i Aleancës, Madrid 2022, miratuar nga kryetarët e shteteve dhe qeverive të vendeve të Aleancës në Samitin e Madrid, 29 qershor 2022.

² Strategjia Ushtarake e NATO-s e miratuar më 2019-n.

³ NATO's Concept for Deterrence and Defence of the Euro-Atlantic Area (DDA).

⁴ The NATO Warfighting Capstone Concept (NWCC).

⁵ Traktati i Atlantikut të Veriut ose Traktati i Uashingtonit, siç njihet ndryshe, është akti themelues i NATO-s nënshkruar nga vendet themelues në Uashington D.C. më 4 prill 1949. Në të, palët zotohen të përmbushin detyrimet si pjesë e Aleancës së mbrojtjes kolektive ku për publikun vlen të përmenden tre nenet më të cituara:

Neni 3 njihet si neni i ngritjes dhe mbajtjes në gatishmëri të kapaciteteve të nevojshme kombëtare për reagim deri në aktivizimin e nenit 5 kur situata e kërkon, dhe thotë: “Me qëllim që të arrihen në mënyrë më të efektshme synimet e këtij traktati palët... do të ruajnë dhe zhvillojnë aftësinë e tyre individuale dhe kolektive për t'i bërë ballë sulmit të armatosur”.

Neni 4 është neni i konsultimit dhe menaxhimit të krizave: “Palët do të këshillohen bashkërisht kurdoherë që, sipas mendimit të cilësdo prej tyre, kërcënohet integriteti territorial, pavarësia apo siguria e cilësdo prej palëve”.

Neni 5 njihet ndryshe si neni i mbrojtjes kolektive dhe shprehet, se “...Palët bien dakord se një sulm i armatosur kundër një apo më shumë prej tyre në Evropë apo në Amerikën e Veriut, do të konsiderohet si sulm kundër të gjitha Palëve, dhe si pasojë bien dakord që, nëse ndodh një sulm i tillë, secila nga ato, në ushtrim të të drejtës së vetëmbrojtjes kolektive apo individuale të njohur nga Neni 51 i Kartës së Kombeve të Bashkuara, do të ndihmojë Palën apo Palët e sulmuara, duke ndërmarrë menjëherë, individualisht dhe në bashkërendim me Palët e tjera, ato veprime që vlerësohen si të nevojshme, përfshirë këtu përdorimin e forcave të armatosura, për të rivendosur dhe ruajtur sigurinë në zonën e Atlantikut të Veriut”.

⁶ Siguria e Përbashkët Evropiane e Mbrojtjes (*Common Security of Defense Policy* – CSDP).

⁷ *Vilnius Summit Communiqué*, 11 korrik 2023, paragrafi 27 dhe 31.

⁸ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.

⁹ Nivel i ambicies (NiA) përcakton numrin dhe madhësinë e operacioneve që FARSH-i duhet të jetë në gjendje të kryejë për të përballuar sfidat dhe përmbushur misionin dhe detyrat apo sasinë e kontributeve që do të ofrojnë në operacionet në kuadër të NATO-s, BE-së dhe OKB-së.

¹⁰ Përcaktimet e kapaciteteve bëhen të planet kombëtare/operacionale për mbrojtjen e vendit.

¹¹ *Vilnius Summit Communiqué*, 11 korrik 2023, para 27 parashikon 2% të PBB-së në vit për investimet e mbrojtjes si dysHEME dhe jo më si tavan.

Shpjegime:

- Termi “kapacitet” (*capacity*) i referohet sasisë, ka të bëjë me madhësinë e forcës, numrave, volumit. Tradicionalisht flitet për personelin, platformat, armët dhe municionit. Janë dy kategori të kapaciteteve: kapacitet i plotë, bruto (*gross capacity*), pra totali i sasisë apo volumit që një forcë përbëhet dhe kapaciteti operacional (*operational capacity*), që zakonisht është terminologji e përdorur në një plan operacional.

Termi “aftësi” (*capability*) ka të bëjë me cilësinë, me performancën e kapacitetit, pra njerëzve, armëve, sistemeve, pajisjeve, lidershipit, komandimit, drejtimit, moralit, mënyrës si mendojmë, trajnohemi, luftojmë dhe përdorim kapacitetet.

Ndërkohë që kapaciteti i referohet diçkaje në numra apo volum, aftësia i referohet mundësisë për të krijuar efekte nëpërmjet përdorimit të integruar të kapaciteteve të shprehur në DOTMELFPI.

- *EU Common Security and Defence Policy*: Politika e Përbashkët e Sigurisë dhe e Mbrojtjes së BE-së.

- Sovraniteti. Sovraniteti është statusi ligjor që shpreh të drejtën e zotërimit të autoritetit suprem dhe të pavarur për të bërë dhe për të zbatuar ligjin dhe ushtruar kontrollin e popullsisë në një territor apo zonë gjeografike të caktuar, autoritet që njihet nga shtetet e tjera sovraNE si zotërues dhe bartës i vetëm i kësaj të drejte. Në shtetet e demokracisë parlamentare, autoriteti sovran është parlamenti.

- Tërësia territoriale, sipas së drejtës ndërkombëtare, është parimi që shpreh se territori që përfshihet brenda kufijve të përcaktuar e të njohur ndërkombëtarisht nën sovranitetin e një shteti të caktuar, është një dhe i pandashëm. Tërësia territoriale përfshin hapësirën tokësore, detare dhe ajrore. Ushtrimi i forcës për ndryshimin e kufijve të territorit përbën një akt agresioni.

- Pavarësia e një shteti është e drejta politike e tij për të ushtruar pushtet politik në të gjithë territorin dhe popullsinë që banon brenda kufijve të përcaktuar e të njohur ndërkombëtarisht, duke qenë i pavarur nga influenca, kontrolli apo vendimmarrja e shteteve të tjera.

- Kapacitete “*Niche*” janë kapacitete të vogla, të specializuara, që kryejnë funksione të unifikuara në njësi shumëkombëshe. Këto kapacitete janë përtej njërive/formacioneve tradicionale. Ato krijohen nga vendet aleate mbi bazën e traditës, eksperiencës, veçorive dhe mundësive të tyre. Të tilla mund të përmendim, ndër të tjera, si ekiye EOD (asgjësimi i municioneve të rrezikshme), CIED (pajisje kundër eksplozivëve të improvizuar), NBRC (masa kundër armëve të shkatërrimit në masë, nukleare, biologjike, radiologjike dhe kimike), OMLT (ekipe për trajnim dhe këshillim operacional), CIMIC (marrëdhënie civilo-ushtarake), MP (polici ushtarake), MAT (ekipe të këshillimit ushtarak) etj.